ENCHIRIDION

Manuale di preghiere
per i fedeli di rito bizantino
in lingua albanese

Scuola Tipografica Salesiana - Palermo

Con approvazione Ecclesiastica

Il presente libretto contiene traduzioni di preghiere liturgiche e inni popolari in lingua albanese, attualmente, in uso a Piana degli Albanesi.

Essi sono opera di alcuni rappresentanti del Clero e del laicato siculo-albanese, quali S. E. Mons. Paolo Schirò, Vescovo titolare di Benda († 1941), *il Papas Prof. Gaetano Petrotta* († 1952) *e il Prof. Giuseppe Schirò* († 1927), *la produzione letteraria dei quali è stata veramente considerevole e molto apprezzata presso i cultori di lingua albanese.*

E' stato per mezzo loro che i fedeli di Piana e degli altri comuni italo-albanesi hanno potuto pregare nella lingua che ricorda la gloriosa loro origine da quegli eroi che 5 secoli fa, sotto la guida di Giorgio Castriota Skanderbeg, lottarono e morirono per difendere la Fede di Cristo.

Ci auguriamo che tutta la produzione letteraria siculo-albanese, nella massima parte religiosa, venga racolta e ordinata in modo che possa servire agli italo-albanesi, che, ancor oggi, nell'Italia Meridionale e in Sicilia, conservano la lingua dei Padri.

PREGHIERE DEL MATTINO

Në embër të Atit, të Birit e të Shpirtit Shejt Ashtù kloft.

Ati i jin . . . .

Falem Mêrì . . . .

Destatici dal sonno, ci prostriamo davanti a Te o Dio buono, e ti cantiamo l'inno degli angeli, o Dio potente: Santo, Santo, Santo sei, o Dio, per l'intercessione della Madre tua abbi pietà di noi.

Gloria al Padre e al Figliuolo e allo Spirito Santo.

Mi hai svegliato dal sonno, o Signore, illumina la mente mia e apri le mie labbra ed il mio cuore per cantarti, Santa Trinità: Santo, Santo, Santo sei, o Dio, per l'intercessione della Madre tua abbi pietà di noi.

Ed ora e sempre e nei secoli dei secoli. Così sia.

All'improvviso il Giudice verrà e le azioni di ciascuno saranno scoperte, perciò spinti dal timore gridiamo nel mezzo della notte: Santo, Santo, Santo sei, o Dio, per l'intercessione della Madre tua abbi pietà di noi.

Destatomi dal sonno Ti ringrazio, o Santa Trinità, che per la tua grande bontà non ti sei adirato con me indolente e peccatore, e non mi hai condannato per i miei peccati, ma, come sempre, hai avuto compassione di me scuotendomi dalla mia insensibilità per farmi vegliare ed adorare lo tua gloriosa potenza. Ed ora illumina gli occhi della mia mente e apri la mia bocca per meditare le tue parole ed intendere i tuoi comandamenti ed adempiere la tua

volontà enell'effusione del cuore lodare èd inneggiare al Santissimo tuo Nome, del Padre e del Figliuolo e dello Spirito Santo, ora e sempre nei secoli dei secoli. Così sia.

ATTO DI FEDE

Mio Dio credo fermamente quanto a Voi, infallibile Verità, avete rivelato e la Santa Chiesa ci propone a credere, ed espressamente credo in Voi, unico vero Dio in tre Persone uguali e distinte, Padre, Figliuolo e Spirito Santo; e nel Figliuolo incarnato e morto per noi, Gesù Cristo, il quale darà a ciascuno secondo i meriti il premio o la pena eterna. Conforme a questa Fede voglio sempre vivere. Signore accrescete la mia fede.

ATTO DI SPERANZA

Mio Dio, spero dalla bontà vostra, per le vostre promesse e per i meriti di Gesù Cristo, nostro Salvatore, la vita eterna e le grazie necessarie per meritarla con le buone opere, che io debbo e voglio fare. Signore, che io non resti confuso in eterno.

ATTO DI CARITÀ

Mio Dio, amo con tutto il cuore sopra ogni cosa Voi, bene infinito e nostra eterna felicità; e per amor vostro amo il prossimo mio come me stesso, e perdono le offese ricevute. Signore fate ch'io vi ami sempre più.

INVOCAZIONE ALL'ANGELO CUSTODE

O custode dell'anima mia e del mio corpo, o Angelo divino, a me destinato da Dio, riguarda a imitazione di lui, con compassione, tutte le colpe della anima mia miserabile: liberami dalle svariate reti del demonio e placa il nostro Dio, affinchè mi usi misericordia nel giorno del giudizio.

VISITA AL SS. SACRAMENTO

Signor mio Gesù Cristo, che per l'amore che portate agli uomini, ve ne state notte e giorno in questo Sacramento tutto pieno di pietà e di amore, aspettando, chiamando ed accogliendo tutti coloro che vengono a visitarvi, io vi credo presente nel Sacramento dell'altare. Vi adoro nell'abisso del mio niente, e vi ringrazio di quante grazie mi avete fatte; specialmente di avermi donato voi stesso in questo Sacramento, di avermi dato per avvocata la vostra Santissima Madre Maria e di avermi chiamato a visitarvi in questa Chiesa.

Io saluto oggi il vostro amantissimo Cuore ed intendo salutarlo per tre fini: primo in ringraziamento di questo gran dono; secondo, per compensarvi di tutte le ingiurie, che avete ricevuto da tutti i vostri nemici in questo Sacramento; terzo intendo con questa visita adorarvi in tutti i luoghi della terra, dove Voi sacramentato ve ne state meno riverito e piú abbandonato.

Gesù mio, io vi amo con tutto il cuore, mi pento di aver per il passato tante volte disgustata la vostra bontà infinita. Propongo con la vostra grazia di non più offendervi per l'avvenire; ed al presente, miserabile qual sono, io mi consacro tutto a Voi: Vi dono e rinunzio nelle vostre mani tutta la mia volontà, gli affetti, i desideri e tutte le cose mie. Da oggi avanti fate Voi di me e delle cose mie, tutto quello che Vi piace. Solo vi chiedo e voglio il vostro santo amore, la perseveranza finale e l'adempimento perfetto della vostra volontà. Vi raccomando le Anime del Purgatorio, specialmente le più devote del Santissimo Sacramento e di Maria Santissima. Vi raccomando ancora tutti i poveri peccatori.

Unisco infine, Salvatore mio caro, tutti gli affetti miei cogli affetti del vostro amorosissimo Cuore e così uniti li offerisco al vostro Eterno Padre; e lo prego in nome vostro, che per vostro amore li accetti e li esaudisca. Così sia.

COMUNIONE SPIRITUALE

Gesù mio, Vi credo presente nel Santissimo Sacramento dell'Altare. Vi amo sopra ogni cosa e vi desidero nell'anima mia. E giacchè ora non posso ricevervi sacramentalmente, venite almeno spiritualmente nel mio cuore. Come già venuto, io Vi abbraccio e tutto mi unisco a Voi. Deh! non permettete che io mi abbia giammai a separare da Voi.



DHOXOLOJIA

Lëvdì Tij, çë dritën na dëftòn e çë jetën dritëzòn.

Lëvdì në të lartit Perëndì e mbi dhe pakjie, ndër njerëzit vulnes'e mirë.

Imnojëm Tij, bekojëm Tij, adhurojëm Tij, lavdërojëm Tij, falënderojëm Tij për vëldìn t'ënde të madhe.

O Zot, o Mbret i kjiellit Perëndì, Ati i gjithmëndëshim.

O Zot, Bir i vetëm, Jesù Krisht; edhè Shpirt i Shejt.

O Zot Perëndì, kjenkji i Perëndis, Biri i Atit, çë nzier mëkatët e jetës, lipisì për ne, o Ti çë nzier mëkatët e jetës.

Prit mir lutien t'ënë, Ti çë rri ujur tek'e drejta e Atit e kijëna lipisì.

Se Ti vetëm je Shejt, Ti vetëm je Zot, Jesù Krisht, në lëvdi të Perëndis Atit. Ashtù kloft.

Ditë për ditë do t'bekoj Tij, do t'lavdëronj embrin t'ënt për jetë e mbë jetë të jetës.

Bën-na të mirë, o Zot, te kjo ditë të ruhemi na të pamëkatë.

I bekuar je, o Zot, Perëndia i Atëravet t'anë, dhe embri jit isht i kënduar e i lavdëruar më jetë të jetëvet. Ashtù kloft.

Klofshit, o Zot, lipisìa jote mbi ne, ashtù si kemi shpresuar tek Ti.

I bekuar jè, o Zot, mësomë Ti të drejtat t'ote. (*tri herë*).

O Zot, Ti pështrimi ke klënë për ne bres pas brezi. U thash: o Zot lipisì për mua; shëndoshëm shpirtin, se përpara Teje mëkatrova.

O Zot, tek Ti u kam gjetur pështrim, mësomë të bënj vullimin t'ënt, se Ti je Perëndia jim.

Se tek Ti isht burimi i gjellës; te drita jote do t'shohiëm na drit.

Zgjerò lipisìn t'ënde mbi atà çë të njohiën.

Shejt Perëndì, Shejt e me fukjì; shejt i pavdekshim, lipisì për ne (*tri herë*).

Vëldì past... nanì e për jetë... Shejt i pavdekshim, lipisì për ne.

SHERBIMI I MESHES

PR.: E bekuar rregjëria e Atit e Birit e Shpirtit Shejt, nanì e për gjith-monë e mbë jetë të jetëvet.

POP.: *Ashtù kloft.*

PR.: Në pakje parkalesiëm t'ën'Zonë.

POP.: *Lipisî, o i Madh'in'Zot*

PR.: Për pakjen s'larti dhe për shëlbimin e shpirtavet t'anë, parkalesiëm t'ën'Zonë.

Për pakjen e gjith jetës, për kjëndrimin e mirë e klishëvet shejte të Perëndis edhè për bashkimin e të gjithëve, parkalesiëm t'ën'Zonë.

Për ktë shpî shejte dhe për atà çë i hijën brënda me besë, me lutësì e me drê të Perëndis, parkalesiëm t'ën'Zonë.

Për të lartin Krieprift Papën e Romës e për Dhespotin t'ënë (*embrin*), për të ndershmën Priftërì, për Dhiakonîn në Krisht, për gjith klerin dhe popullin, parkalesiëm t'ën'Zonë.

Për ktë klishë shejte, për çdo horë dhe vent e për atà çë rrinë ndë'to me besë, parkalesiëm t'ën'Zonë.

Për pastrimin e erëvet, për burin e pemëvet të dheut e për kjëronjë të pakjëshmë, parkalesiëm t'ën'Zonë.

Për atà çë ndodhen mbi dejt, për në dhrome, të sëmurë, të kurrusmë, në fulakjì dhe për shëlbimin e' tire, parkalesiëm t'ën'Zonë.

Sa të jemi të ruajtur nga çdo helm, hidhërim, rrëzik dhe nevojë, parkalesiëm t'ën'Zonë.

Ndihna, shpëtona, kijëna lipisî dhe ruana, o Perëndì, me hirin t'ënt.

Tue kujtuar gjith-shejten të pamëkatë, të bekuamen mbi të gjithë, të lëvdoshmen Zonjën t'ënë Mëmën e Perëndîs e po Virgjërën e Shë'Mërî, bashk me gjith Shejtrat, truajëm njeri t'jatrin edhè gjithë gjellën t'ënë, Krishtit Perëndî.

Pop.: Tij, o i Madh'in'Zot.

Pr.: Se Tij të nget ç'do lëvdì, nderim edhè proskjinî, Atit e Birit edhè Shpirtit Shejt, nanì e për gjith-monë e mbë jetë të jetëvet.

Pop.: *Ashtù kloft.*

Antifona e Parë

Shum bukur isht të lëvdojëm t'ën' Zonë e të këndojëm embrin t'ënt, o i Larti in'Zot.

Pop.: *Për parkalesitë të Mëmës t'ënde, o Shelbues, jipna shëndet.*

Pr.: Pameta e përsëri në pakje, parkalesiëm t'ën'Zonë.

Ndihna, shpëtona, kijëna lipisî dhe ruana, o Perendî, me hirin t'ënt.

Tue kujtuar gjithëshejten të pamëkatë, të bekuamen mbi të gjithë, të lëvdoshëmen Zonjën t'ënë Mëmën e Perëndîs e po Virgjërën e Shë'Mërî, bashk me gjith Shejtrat truajëm njeri tjatrin edhè gjith gjellën t'ënë, Krishtit Perëndî.

Se jotja isht pushtetjia dhe jotja isht rregjëria, fukjia dhe lëvdia e Atit e Birit edhè Shpirit Shejt, nanì e për gjith-monë e mbë jetë të jetëvet.

Pop.: *Ashtù kloft.*

Antifona e Dytë

In'Zot isht Rrekj e vishet me ndër të math e in' Zot vishet e me fukji rrethonet.

Pop.: *Për parkalesitë të gjithë Shejtravet jipna shëndet, o i Madh'in'Zot.*

Vëldì Atit e Birit edhè Shpirtit Shejt, nanì e për gjith-monë e mbë jetë të jetëvet. Ashtù kloft.

O i vetmi Bîr e Fjalë e Perëndîs, Ti çë jê i pavdekshëm, deshe të njerëzonëshe e të mirrie kurm për shëndetën e shpirtit t'ënë në gjî të Shejtes Mëmë e po Virgjërë e Shë'Mërî. Ti çë pa ndërruar njerî u bëre e kleve vunë ngrikj, o Krisht Perëndî, me vdekjen vdekjen shkele. Ti çë jê një nga Trinia Shejte bashk lëvduar me Atin e me Shpirtin Shejt, shpëtona.

Pr.: Pameta e përsëri në pakje, parkalesiëm t'ën'Zonë.

Ndihna, shpëtona, kijëna lipisî dhe ruana, o Perëndî, me hirin t'ënt.

Tue kujtuar gjith-shejten të pamëkatë, të bekuamen mbi të gjithë, të lëvdoshëmen Zonjën t'ënë Mëmën e Perëndîs e po Virgjërën e Shë'Mërî, bashk me gjith Shejtrat truajëm njeri tjatrin edhè gjithë gjëllën t'ënë, Krishtit Perëndî.

Se Ti je Perëndî i mirë e çë do mirë njerëzîn, e na Tij japiëm lëvdì Atit e Birit edhè Shpirtit Shejt, nanì e për gjith-monë e mbë jetë të jetëvet.

Pop.: *Ashtù kloft.*

Antifona e Tretë

Ejani gzonemi në t'ën'Zonë, bëjëm gzim në Perëndî, shëndetja jonë.

Pop.: *O Ti, çë s'vdekurish u ngjalle, o Bîr i Perëndîs, shpëtò neve çë të këndojëm. Alliluia.*

Pr.: Diturì! Shtuara!

Pop.: *Ejani t'i falemi e t'i përmisemi Zotit Krisht. O Ti, çë s'vdekurish u ngjalle, o Bîr i Perëndîs, shpëtò neve çë të këndojëm. Alliluia.*

Pr.: Parkalesiëm t'ën'Zonë.

Pop.: *Lipisî, o i Madh'in'Zot.*

Pr.: Se Ti jê Shejt, o Perëndia jinë, e na Tij japiëm lëvdì Atit e Birit edhè Shpirtit Shejt, nanì e për gjith-monë e mbë jetë të jetëvet.

Pop.: *Ashtù kloft.*

Trisajion

Pop.: *Shejt Perëndî, shejt e me fukjì, shejt i pavdekur, kîj lipisî për ne* (tri herë) (1).

Lëvdì past... nanì e për gjith-monë...

Shejt i pavdekur, kîj lipisî për ne.

Apostulli

Pr.: Le te vum rê - Diturì - Le të vum rê.

Pop.: Si sos Apostulli: *Alliluia* (tri herë).

(1) *Te Mesha e Madhe Dhespoti bekòn tue thënë*: « Zot, o Zot, prîr siun t'ënt nga kjiellia é vërrêj é shih é kij kujdes për ktë vreshtë pse e vuri e drejta e jote ».

Vangjeji

Pr.: Diturì, gjithë shtuara, gjegjemi Vangjejin Shejt. Pakje të gjithëve.

Pop.: *Edhè Shpirtit t'ënt.*

Pr.: Këndimi prej Vangjejit Shejt pas Shën.....

Pop.: *Lëvdì Tîj, o i Madh'in'Zot, lëvdi Tîj.*

Pr.: Le të vum rê.

Pop.: *Lëvdì Tîj, o i Madh'in'Zot, lëvdì Tîj. Për shumë vjet, o Zot.*

Pr.: Le të thomi të gjithë, me gjithë shpirtin e me gjithë mendjen t'ënë, le të thomi.

Pop.: *Lipisî, o i Madh'in'Zot.*

Pr.: O Zot, i gjith-mëndëshëm, Perëndia i atëravet t'anë, na të parkalesiëm, Ti gjegjëna e kijëna lipisî.

Kijëna lipisî, o Perëndî, pas të madhes lipisî s'ate, na të parkalesiëm, Ti gjegjëna e kijëna lipisî.

Pameta parkalesiëm për Dhespotin t'ënë... (*embrin*) e për të ndershmen priftërì.

Pameta parkalesiëm për vëllezërit t'anë, për priftrat, për kallogjerit e për gjithë vëllezërinë t'ënë në Krisht.

Pameta parkalesiëm për lipisî, gjellë, pakje, shëndet, shëlbim, vizitë, falje dhe ndjesë të mëkatëvet të shërbëtorëvet të Perendîs, të vëllezërvet të ksaj klishie shejte.

Pameta parkalesiëm për të lumët e të paharruashëm stisorë të ksaj klishie shejte e për gjithë atërat e vëllezërit t'anë të vdekurë çë ktu kanë prëhje në t'ën'Zonë e për të besmit të gjithë jetës.

Pameta parkalesiëm për atà çë japiën ndihmë dhe çë shërbejën me zëmbrë te kjo klishë shejte e për gjith gjinden çë ktu ndodhen e çë ngak Ti pret të madhen e të buroshme lipisî.

Pop.: *Për shumë vjet, o Zot.*

Pr.: Se Ti je Perëndî i lipisiar e çë do mirë njerëzît e Tîj na japiëm lëvdì, Atit e Birit edhè Shpirtit Shejt, nanì e për gjith-monë e mbë jetë të jetëvet.

Pop.: *Ashtù kloft.*

Pr.: Parkalesëni ju katikumenët t'ën'Zonë.

Pop.: *Lipisî, o i Madh'in'Zot.*

Pr.: Na të besmë për katikumenët parkalesiëm.

Sa i Madh'in'Zot të ket lipisî për atà.

Sa t'i mësonjë atireve fialën e së vërtetës.

Sa t'i sbëlonjë atireve Vangjejin e drejtësis.

Sa t'i përbashkonjë me klishën e Tîj të shejte, katholike dhe apostolike.

Shpëtoi, kiji lipisî, ndihi dhe ruaji, o Perëndî, me hirin t'ënt.

O ju katikumenë, ujëni krerët tuaja t'in'Zoti.

Pop.: *Tîj, o i Madh'in'Zot.*

Pr.: Sa dhe atà të vëldojën bashk me ne embrin t'ënt të ndershëmin, të madhështor, të Atit, të Birit edhè të Shpirtit Shejt, nanì e për gjith monë e mbë jetë të jetëvet.

Pop.: *Ashtù kloft.*

Pr.: Ju sa jini katikumenë dilni; o katikumenë dilni. Sa jini katikumenë dilni. Mosnjerî prej katikumenët të kjëndronjë. Na sa jemi të besmë, pameta e përsërì në pakje parkalesiëm t'ën'Zonë.

Ndihna, shpëtona, kijëna lipisî dhe ruana, o Perëndî, me hirin t'ënt.

Diturì!

Se Tîj të nget ç'do lëvdì, nderim dhe proskjinì, Atit e Birit edhè Shpirtit Shejt, nanì e për gjith-monë e mbë jetë të jetëvet.

Pop.: *Ashtù kloft.*

Pr.: Pameta e përsëri në pakje parkalesiëm t'ën'Zonë.

Ndihna, shpëtona, kijëna lipisî dhe ruana, o Perëndî, me hirin t'ënt.

Diturì!

Pr.: Sa na të ruajtur për gjithë jetën t'ënë nga pushteti jit, të të dërgojëm lëvdì, Atit e Birit edhè Shpirtit Shejt, nanì e për gjith-monë e mbë jetë të jetëvet.

Pop.: *Ashtù kloft.*

Gjith'na Hjeruvimt mistikisht tue korëzuar e Trinisë gjellëdhënëse, trishejten kënkë tue kënduar, të lëmë na të gjitha kujdesat e të kësaj gjellie; sa Rregjin...

Isodhos

Pr.: Për gjith ne u-kujtoftë Zoti Perëndi te rregjëria e Tîj, kurdoherë, nanì e për gjith-monë e mbë jetë të jetëvet.

Pop.: *Ashtù kloft.*

...e gjith jetës të presiëm se vjen bashk me ushtrit e Engjëjvet i padukur. Alliluia

Pr.: Mbarojëm parkalesinë t'ënë t'in'Zoti.

Pop.: *Lipisî, o i Madh'in'Zot.*

Pr.: Për dhuratat të shtrejta çë kemi përpara, parkalesiëm t'ën'Zonë.

Për ktë shpî shejte dhe për atà çë i hijën me besë, me lutësî e me drê të Perëndîs, parkalesiëm t'ën'Zonë.

Sa të jemi të ruajtur nga ç'do helm, hidhërim, rrëzik dhe nevojë, parkalesiëm t'ën'Zonë.

Ndihna, shpëtona, kijëna lipisî dhe ruana, o Perëndî, me hirin t'ënt.

Ditën e tërë, të mbarë, të shejte, të pakjëshme, të pamëkatëshme, le t'i lipiëm t'in'Zoti.

Pop.: *Jipna, o i Madh'in'Zot.*

Pr.: Engjëllin pakjie të na dëftonjë dhromin me besë e të na ruanjë shpirtrat e kurmet t'anë, le t'i lipiëm t'in'Zoti.

Ndjesën dhe faljen e mëkatëvet e të ftesavet t'ona, le t'i lipiëm t'in'Zoti.

Gjith të mirat e atò çë i duhen shpirtravet t'anë, dhe pakjen për jetën, le t'i lipiëm t'in'Zoti.

Sa të shkojëm në pakje e në pendim gjith kjëroin çë na kjëndron të gjellës t'ënë, le t'i lipiëm t'in'Zoti.

Një vdekje të krështerë, pâ dhëmbime, pâ kjërtime, të pakjëshme e një fjalë të mirë përpara të trëmbëshmes ligjë, le t'i lipiëm t'in'Zoti.

Tue kujtuar gjith-shejten të pamëkatë, të bekuamen mbi të gjithë, të lëvdoshmen Zonjën t'ënë, Mëmën e Perëndis e po Virgjërën e Shë'Mërî, bashk me gjith Shejtrat truajëm njeri tjatrin edhè gjithë gjellën t'ënë, Krishtit Perëndî.

Pop: *Tîj, o i Madh'in'Zot.*

Pr.: Për lipisî të Birit t'ënt të Vetmit me të çilin je i bekuar bashk me gjith-shejtin e të mirin e gjellëdhënësin Shpirtin t'ënt, nanì e për gjithmonë e mbë jetë të jetëvet.

Pop.: *Ashtù kloft.*

Pr.: Pakje të gjithëve.

Pop.: *Edhè Shpirtit t'ënt.*

Pr.: Le të duhemi mirë njeri me tjatrin sa me një mendje të skomollisiëm.

Pop.: *Atin, Birin edhè Shpirtin Shejt, Trinìn gjithë një klënie e të pâ-ndarëshme.*

Pr.: Diert, diert! me diturì le të vum rê.

Besimi

Pop.: U kam besë mbë një Perëndî, Atin e gjithpushtetëshëm, Krijuesin e kjielliës e të dheut, edhè të gjithë të dukuravet e të pâ-dukuravet. E mbë një Zot, Jisù Krishtin, Birin e Perëndîs të vetëmlindurin, i çili leu nga Ati më parë se gjithë jetëtë. Dritë nga dritë, Perëndî i vërtetë nga Perëndî i vërtetë, i ler jo i bër, gjithnjëj-klënie me Atin për anë të çilit gjith-kjish u bën. I çili për ne njerëzît è për shpëtimin t'ënë u sdrip nga kjielliat è u mishërua prej Shpirtit Shejt e Virgjërës Mërî è u bë njerî. I çili kle vunë n'krikj për ne nën Pontsië Pilatit e vuajti e kle varrzuar. E u ngjall më të tretën ditë pas të Shkruamvet. E u ngjip në kjiell e rri tek e drejta e të Atit. E kat vinjë pameta me levdì të gjikonjë të gjallët e të vdekurit, rregjëria e të çilit ngë ka për të sosur. E mbë Shpirtin Shejt,

Zotin, Gjellëdhënësin çë rrieth nga Ati, çë adhuronet e lëvdëronet bashk me Atin e me Birin, e çë foli për gojë të Profetravet. Mbë Klishën Një, Shejte, Katholike e Apostolike. U rrëfienj një Pagëzim për ndjesë të mëkatëvet. Pres ngjalljen e të vdekurvet e gjellën e jetës s'jardhëshme. Ashtù kloft.

Anafora

PR.: Rrim me lutësî, rrim me drê, le të vum rê të japiëm në pakje dhuratën e shejte.

POP.: *Lipisî pakjëje, therore lëvdimi.*

PR.: Hiri i t'in'Zoti Jesù Krishtit e dashuria e Perëndîs Atit e kungimi i Shpirtit Shejt, kloft me gjith ju.

POP.: *Edhè me Shpirtin t'ënt.*

PR.: Le të ngrëjëm lart zëmbrat t'ona.

POP.: *I kemi në t'ën'Zonë.*

PR.: Haristisiëm t'ën'Zonë.

POP.: *Shum mirë isht edhè drejt të proskjinisiëm Atin, Birin edhè Shpirtin Shejt, Trinìn gjithë një klënie e të pandarëshme.*

PR.: Hymnin mundësor, tue kënduar, tue lurijtur, tue thirrur e tue thënë:

POP.: *I Shejt, i Shejt, i Shejt in'Zot Savaoth, plot isht kjielli e dheu me lëvdin t'ënde: Osanna më të lartit, i bekuar kush vjen në emër të t'in' Zoti. Osanna më të lartit.*

PR.: MIRRNI, HANI; KI ISHT KURMI JIM ÇE THIHET PER JU, PER NDJESE TE MEKATEVE.

POP.: *Ashtù kloft.*

PR.: PINI PREJ KETIJ TE GJITHE; KI ISHT GJAKU JIM, I DHIATES SE RE, ÇE DERDHET PER JU DHE PER SHUME, PER NDJESE TE MEKATEVE.

POP.: *Ashtù kloft.*

PR. Shërbiset t'ote ndër t'otet.

POP.: *Të lëvdojëm, të bekojëm, të haristisiëm, o i Madh'in'Zot, e të parkalesiëm, o Perëndia jinë.*

PR.: Më se më për gjithë Shejten, të pamëkatë, të bekuamen mbi të gjithë, të lëvdoshmen Zonjën t'ënë Mëmën e Perëndîs e po Virgjërë e Shën Mëri.

POP.: I Math isht embri i Shejtes Trini.

Shumë mir isht me të vërtetë sa të thomi Tij të lume Zonjë, gjith-monë të lumëshme dhe të papërlieme edhè Mëmë të të Madhit Zot. Tij më të nderoshme se Hjeruvimt e pâ të përkrahur më të lëvdoshme se Serafimt, çë pâ fare u ndohur të Lartën Fjalë linde, vërteta Mëmë e t'in'Zoti, po madhërojëm na.

PR.: Më para kujtou, o Zot, për të Lartin Krieprift Papën e Romës e Dhespotin t'ënë N., të çilët mbaji mbi klishët e shejte t'ote në pakje, të shpëtuar, të nderuar, të shëndoshë, me gjellën të glatë, sa të ligjërojën me të drejt fjalën e së vërtetës t'ënde.

POP.: *E për të gjithë e për të gjitha.*

PR.: E bën sa na me një gojë e me një zëmbër të lëvdojëm e të këndojëm embrin t'ënt të përndershëm e madhështor, të Atit, të Birit edhè të Shpirtit Shejt, nanì e për gjith-monë e mbë jetë të jetëvet.

POP.: *Ashtù kloft.*

PR.: E lipisît e të Madhit Perëndî e Shëlbuesit t'ënë Jesù Krisht klofshin me gjith ju.

POP.: *Edhè me Shpirtin t'ënt.*

PR.: Tue kujtuar gjithë Shejtrat pameta e përsëri në pakje, parkalesiëm t'ën'Zonë.

POP.: *Lipisî, o i Madh'in'Zot.*

PR.: Për dhuratat e shtrejta çë kanë klënë bër e çë kanë klënë shejtëruar, parkalesiëm t'ën'Zonë.

Sa Perëndia jinë çë do mirë njerëzît, çë i ka pritur në otarin e tîj i shejt e i kjiellëshëm e i ndëlgoshëm në bukurerë pëlkjimi shpirtullor të na dërgonjë për çpërblim, të huinushëmin hîr e dhuratën e Shpirtit Shejt, parkalesiëm t'ën'Zonë.

Sa të jemi të ruajtur nga ç'do helm, hidhërim, rrëzik dhe nevojë, parkalesiëm t'ën'Zonë.

Ndihna, shpëtona, kijëna lipisî dhe ruana, o Perëndî me hirin t'ënt.

Ditën e tërë të shejte, të pakjëshme dhe të pamëkatëshme, le t'i lipiëm t'in'Zoti.

POP.: *Jipna, o i Madh'in'Zot.*

PR.: Engjëllin pakjie të na dëftonjë dhromin me besë e të na ruanjë shpirtrat e kurmet t'anë, le t'i lipiëm t'in'Zoti.

PR.: Ndjesën dhe faljen e mëkatëvet e të ftesavet t'ona, le t'i lipiëm t'in'Zoti.

Gjith të mirat e atò çë i duhen shpirtravet t'anë, dhe pakjen për jetën, le t'i lipiëm t'in'Zoti.

Sa të shkojëm në pakje e në pendim gjith kjëroin çë na kjëndròn të gjellës t'ënë, le t'i lipiëm t'in' Zoti.

Një vdekje të krështerë, pâ dhëmbime, pâ kjërtime, të pakjëshme e një fjalë të mirë përpara të trëmbëshmes ligjë, le t'i lipiëm t'in'Zoti.

Tue lipur njësîn e besës e kungimin e Shpirtit

Shejt, truhemi na e njeri tjatrin e gjithë gjellën t'ënë, Krishtit Perëndî.

POP.: *Tîj, o i Madh'in'Zot.*

PR.: E bëna të mirë, o Zot, sa me zëmbër e pâ ftesë të kudsojëm të thëresjëm Tîj Perëndî, At i kjiellëshëm e të thomi:

POP.: *Ati i jinë çë je në kjiell, shejtëruar kloft embri jit, arthtë rregjëria jote, u bëftë vullimi jit, si ndë kjiell ashtù ndë dhe. Bukën t'ënë të përditëshmen ëna neve sot, ndëjena dëtiret t'ona ashtù si na ja ndëjejëm të dëtëruamvet t'anë e mos na le të biem ndë ngarie, po lirona nga i ligu.*

PR.: Se jotja isht rregjëria, dhe fukjia dhe lëvdia e Atit e Birit edhè e Shpirtit Shejt, nanì e për gjith-monë e mbë jetë të jetëvet.

POP.: *Ashtù kloft.*

PR.: Pakje të gjithëve.

POP.: *Edhè Shpirtit t'ënt.*

PR.: Kriet t'aj ujëni përpara t'in'Zoti.

POP.. *Tîj, o i Madh'in'Zot.*

PR.: Për hir, për lipisî e për mirësî e të vetmit Birit t'ënt me të çilin je bekuar, bashk me gjith shejtin e të mirë e gjellëdhënës Shpirtin t'ënt, nanì e për gjith-monë e mbë jetë të jetëvet.

POP.: *Ashtù kloft.*

PR.: Le të vumë rê!

POP.: *Për ndihmë të gjithë të besmëvet e të krështerë të vërtetë.*

PR.: Të shejtat, shejtravet.

POP.: *Një vetëm Shejt, një vetëm in'Zot, Jesù Krishti, në lëvdì të Perëndîs Ati. Ashtù kloft.*

Parkalesia më parë se kungimi

O Shelbuesi jim, shejtërò mendjen t'ime, shpirtin t'im, zëmbrën t'ime e kurmin t'im e bëmë Ti i mirë, të kjasem pâ drê dënimi përpara të t'meruamvet misteret t'at, i Madh'in'Zot; o Fjala e Perëndî i Shejt, nanì çë kjasem përpara misterevet t'at të hjenushëm, shejtëromë gjith për parkalesitë e Shejtes Mëmës t'ënde; o Zoti Krisht mos llargomë të marr kurmin e gjakun t'ënt të hjenushm, po bëmë Ti të marr pjesë të Shejtravet e të tmeruamvet Mistere t'at e të mos jenë për mua për dënim, po për gjellë të pasosmë e të pavdekëshme.

U kam besë, o i Madh'in'Zot, se Ti je vërteta Krishti i Biri i Perëndîs të gjallë, çë jerdhe te jeta sa të shpëtoje të mëkatruamit ndër të çilët i pari jam ù.

U kam besë se ki isht vërteta Kurmi jit i dëlirë e se ki isht vërteta Gjaku jit i paçëmuashmë. Kij lipisî për mua, ndjemë gjithë mëkatët çë u kam bërë me vughimin t'im e pâ dashur, me të dijtur e pâ dijtur, me fjalë e me të bëme. Bëmë, Ti i mirë, të marr pjesë te Misteret t'at të dëlirë pâ drê dënimi, po sa të kem ndjesën e mëkatëvet e gjellën e pasosme. Ashtù kloft.

Patçe për mua lipisî, o i Madh'in'Zot! U ndienj pendìm, o i Larti Perëndî, dhëmbem e helmonem me gjith zëmbër për gjith mëkatët çë kam bur te gjella jime. Helmonem se kam sbierrë Parraisin e më nget Pisa; po më shumë më dhëmp zëmbra, se tue mëkatruar, kam ftesur Tij, o i Madh'in'Zot, çë

je gjith e mira e çë ka dua mirë mbi gjithë shërbiset. U të taks me të vërtetë, me ndihmën t'ënde, të mos të t'ftes më me mëkatën t'ime. Vdeksha më mirë, po të dafsha mirë e të shërbefsha Tij, o i Madh'in'Zot, i mirë e i ftet klofsha me Tij për gjithmonë. Ashtù kloft.

Eja, o Zot e Perëndî,
Në ktë zëmbrë e në ktë gjî;
U të pres me lot ndër sî
Me gzim e trëmbësì,
Me tërbim e me harè
Te ki shpirt çë mua më dhe.
Për ktë shpirt te jeta jerdhe,
E për mua gjith gjakun derdhe
Për atë gjak të parkales
Ipmë hîr sa mos të t'ftes
Perëndî tri herë Shejt;
Te kjo zëmbër eja shpejt
Eja shpejt e mos mënò,
E ktë shpirt më shejtërò.
Mos t'vërresh, o i Madh'in'Zot,
Se u jam një grushtëth botë
Po t'kujtosh se Ti je At
Eja njize somenàt.

Të darkës t'ënde mistike, o i Bîr i Perëndîs, vur sot në pjesë edhè mua; se u armikjëvet t'at Misterin t'ënt ngë i thom, e ngë të puth si të puthi Judha po si Kusari i mirë u të thom: për mua kujtou, o Zot, (o Krisht o Regj) te rregjëria jote.

Pr.: Me drê të Perëndîs, me besë e me dashurì kjasij.

Pop.: *Ashtù kloft, ashtù kloft, bekuar kush vjen*

në embër të t'in 'Zoti; Perëndia ë Zoti, edhè na u dëftua neve.

Pr.: Shpëtò, o Perëndî, popullin t'ënt, edhè bekò trashgimin t'ënt.

Pop.: *Për shumë vjet, o Zot.*

Kemi parë dritën e vërtetë, kemi marrë Shpirtin e kjiellëshëm, kemi gjetur besën e vërtetë, tue proskjinisur Trinin e pandarëshme, se kjo na pruri shëndetën.

Pr.: (Bekuar Perëndia...) Për gjith-monë, nani e mbë jetë të jetëvet.

Pop.: *Ashtù kloft. Për ndjesë të mëkatëvet e për gjellë të pasosme, Alliluia* (tri herë)

Pr.: Shtuara! posa u kemi kunguar me misteret të hujnushmë, të dëlirë, të pavdekshmë, të kjellëshmë, gjellëdhënësë e të tmeruashmë të Krishtit si i nget haristisiëm t'ën 'Zonë.

Pop.: *Lipisî, o i Madh 'in 'Zot.*

Pr.: Ndihna, shpëtona, kijëna lipisî dhe ruana, o Perëndî, me hirin t'ënt.

Ditën e tërë të mbarë, të shejte, me pakje e pamëkatë tue lipur, truhemi ndër nesh e njeri tjatrin e gjithë gjellën t'ënë Krishtit Perëndî.

Pop.: *Tij, o i Madh'in'Zot.*

Pr.: Se Ti je shejtërimi jinë e Tij na dërgojëm lëvdì, Atit, Birit edhè Shpirtit Shejt, nanì e për gjith-monë e mbë jetë të jetëvet.

Pop.: *Ashtù kloft.*

Pr.: Le të vemi në pakje.

Pop.: *Në embër të t'in'Zoti.*

Pr.: Parkalesiëm t'ën'Zonë.

Pop.: *Lipisî, lipisî, lipisî, bekò, o Zot.*

Pr.: O Ti çë bekòn atà çë të bekojën, o i Madh' in'Zot, e çë shejtëròn atà çë tek Tij kanë besë, shpëtò, o Perëndî, popullin t'ënt e bekò trashgimin t'ënt, ruaje plotësinë e klishës s'ate; shejtërò atà çë duan hjen e shtëpisë s'ate. Ti lëvdoji për shpërblìm me fukjinë t'ënde të hujnushme, dhe mos na ler neve çë kemi shpresë tek Tij. Jipi pakjen jetës s'ate e klishavet t'ote, priftravet e rregjëravet t'anë, ushtëris e gjith popullit t'ënt. Se ç'do dhënie e mirë dhe ç'do dhuratë e mbarë vjen së larti tue u-sdripur prej Teje, Ati i dritravet, e Tij na dërgojëm lëvdì, përhirim dhe proskjinì, Atit e Birit edhè Shpirtit Shejt, nanì e për gjith-monë e mbë jetë të jetëvet.

Pop.: *Ashtù kloft.*

Embri i t'in'Zoti kloft i bekuar çë nanì e për gjith-monë (tri herë).

Pr.: Parkalesiëm t'ën'Zonë.

Pop.: *Lipisî, o i Madh'in'Zot.*

Pr.: Bekimi dhe lipisia e t'in'Zoti arthtë mbi ju, me hirin e tij dhe dashurin, për gjith herët, nanì e për gjith-monë e mbë jetë të jetëvet.

Pop.: *Ashtù kloft.*

Pr.: Lëvdì Tij, o Krisht Perëndî, shpresa jonë, lëvdì Tij.

Pop.: *Lëvdì Atit e Birit edhè Shpirtit Shejt, nanì e për gjith-monë e mbë jetë të jetëvet. Ashtù kloft. Lipisî, lipisî, lipisî, bekò, o Zot.*

Pr.: O Ti çë je i famasmë ndër Shejtrat (çë u ngjalle së vdekurish) o Krisht Perëndî i vërtetë, për parkalesitë të papërliemes Zonjës t'ënë Mëma e Perëndìs e gjith-monë Virgjërë e Shën Mëri, për

virtut të të ndershmës e gjellëdhënës Krikje, për ndihmën e të ndershmit e të vëldoshmit Profit Prodhrom e Pagzôr Shën Jani e të vëldoshmit Apostoj e të ndershmit Shejtra e Dëshmorë, e Atrat t'anë të shejtë e të Shejtravet e të drejt Gjishrat e Perëndis Joakim e Anna e për parkalesit të gjithë Shejtravet kijëna lipisî e ruana Ti se je, Perëndî i mirë e çë do mirë gjith njerëzît.

Pop.: *Ashtù kloft.*

Kinonika

Enite: *Lëvdoni t'ën'Zonë ju nga Kjielli, po lëvdoni Atë te më i larti kjiell. Alliluia.*

Potirion: *Kupëzën shëndetje u dua të marr, embrin e t'in'Zoti u kam të thërres. Alliluia.*

Is mnimosinon: *Për kujtim të përjetëshëm ka të jêt i drejti. Alliluia.*

Parkalesia pas kungimit

Të falem nderies s'ate, o Zot, Perëndia jim, se ngë rreshte mua të mëkatruam, po më bëre i mirë të kungonesha me shejtërimet t'at.

Të haristis se mua të pavjefshëm më vure në pjesë të dhuratavet t'at të dëlira e të kjiellëshme. Po, o Zot, çë do mirë njerëzit, çë për ne vdikje e u ngjalle, e na dhurove këtà të dreruashmë e gjellëdhënësë Mistere për të mirën e shejtërimin të

shpirtëravet e kurmëvet t'anë, bëj sa të jenë edhè për mua për shëndetën e shpirtit e të kurmit t'im, për të llarguarit e çdo armiku, për të ndriturit e sivet të zëmbrës t'ime, për pakje të fukjivet t'ime shpirtullore, për besë pa turp, për dashurì të pa pështrìm, për të mbushur diturie, për të ruajtur urdhurimet t'atë, për të shtuar dhuratën të perëndishme e për të trashguar rregjërinë t'ënde. Se kështù tue u ruajtur me këtà Mistere te shejtërimi i jit, u kujtonj kurdoherë dhuratën t'ënde e ngë rronj më për mua, po për Tij, o Zot i jinë e mirëbërësi i jinë. E kështù tue u llarguar nga këjò jetë me shpresën e gjellës të pasosme të kem të përherëshmen prëhie te ku ngë pushòn zëri i të lumëvet çë bëjën haidhì e te ku i pa-masë isht pëlkjimi i atireve çë po shohiën bukurìn e fakjes s'ate. Përçë Ti je vërteta dëshiri i pa-llojasëm, gëzimi i atireve çë të duan mirë, o Krisht Perëndia jinë e gjith kriesa të lëvdòn për gjith monë.


Ashtù kloft.


O Zoti Krisht Perëndì, rregji i gjithë jetëvet e kriuesi e gjithësis, te haristìs për gjithë të mirat, çë më ke dhënë e për marrëpjesjen të Misterëvet t'atë të dëlirë e gjellëdhënësë.

Të lutem, o i mirë e çë do mirë njerëzit, ruajëmë nën pështrimin t'ënt e te hjeja e krahëvet t'atë e ëm sa me zëmbrën e dëlirë, njera tek e sprasmia frimë të jem i mirë të marr pjesë te shejtërimet t'atë për ndjesë të mëkatëvet e gjellë të pasosme. Përçë vërteta Ti je buka e gjellës, kroi i shejtërimit, dhënësi i të miravet e të faliëm lëvdì Tij me

Atin e me Shpirtin Shejt, nani e për gjith monë e për jetë të jetëvet. Ashtù kloft.

Gjith e Shejte Mbretëreshë Mëma e t'in'Zoti, dritë e t'errëtit shpirtit t'im, shpresa, pështrimi, shpëtimi i jim, ngushëllimi jim, gëzimi jim, Të haristîs, se, mua të pavjefshëm, më bëre të kungonesha me të dëlirin kurm e të çmuamin gjak të Birit t'ënt. Po Ti çë linde dritën të vërtetë, ndritëm sit shpirtullorë të zëmbrës t'ime. Ti çë linde kroin i pa-vdekjes, ip gjellën mua të vdekurë te mëkata. O Ti çë je gjith lipisì, Mëma e t'lipisiarit Perëndi, kij lipisí për mua e ëm pendimin e dhëmbimin te zëmbra jime, e përunjësin te mendimet t'im dhe të të thërres nga robëria e'tire. E bëjëmë të mirë, njera tek e sprasmia frimë të marr pa kjërtim shejtërimin e të dëlirëvet Mistere për shëndetën e shpirtit e të kurmit; e ëm lot pendimi e skomollie sa gjith ditët e gjellës t'ime të të këndonj e të të lëvdonj, përçë e lëvduame dhe e bekuame je për jetë. Ashtù kloft.





POLIELEOS (ps. 135)

Lartësoni t'ën'Zonë se isht i mirë.

Pop. - *Alliluia. Se e pasosme isht lipisia e tij-Alliluia.*

Lartësoni Perëndin e Perëndiravet.
Lartësoni Perëndin e Perëndiravet.
Atë çë bën famasmë të mbëdha i vetëm.
Atë çë bëri kjielliat me mendje.
Atë çë shtroi dheun mbi ujërat.
Atë çë bëri dritëzit e mbëdhenj i vetëm...
Diellin për urdhër të ditës...
Hënzën e izet për urdhur të natës...
Atë çë rrahu Egjiptin bashk me paralindësit e tireve...
Atë çë ndsori Israelin ndër mes t'atireve...
Me dorë të fortë e me krah të glat...
Atë çë ndajti Dejtin e kukj ndìsh...
Atë çë bëri të shkoj Israeli ndër mes t'atij...
Atë çë shtu Faraonin e ushtrin e tij te Dejti i Kukj...
Atë çë kjelli popullin e 'tij për në shkretëtirë.
Atë çë mundi rregjërat të mbëdhenj...
E çë vrau rregjëra të fortë...
Sionin, rregjin e Amorrenjëvet. E Ogin rregjin e Basanit...

E çë dha dheun e atireve për trashgim...
Trashgim Israelit popullit e tij...
Se te njerëzia jonë u kujtua për ne in'Zot...
E liroi neve nga armikjët t'anë.
Ai çë jep të ngrënë gjith njeriu...
Lartësoni Perëndin e Kjielliës.



TRISAGHION

Bashkë me shpirtrat e të drejtëvet të mbaruar, prëhe, o Shelbues, shpirtin e shërbëtorit t'ënt (e shërbëtores t'ënde) (prëhi shpirtrat e shërbëtorëvet t'ënt) e rruaje (e rruaji) te gjella e lumë çë isht pranë Teje, o Ti çë do mirë njerëzit.

Te prëhja e jote, o Zot, te ku prëhen gjith shejtrat t'at, prëhe dhe shpirtin e shërbëtorit t'ënt (e shërbëtores t'ënde) (prëhi dhe shpirtrat e shërbëtorëvet t'ënt) se Ti je vetëm i pa-vdekur.

Lëvdì past...

Ti je Perëndia çë sdripe te Pisa e sglidhe dhëmbjet e të lidhurvet; Ti, o Shelbues, prëhe dhe shpirtin e shërbëtorit t'ënt (e shërbëtores t'ënde) (prëhi dhe shpirtrat e shërbëtorëvet t'ënt).

Nanì e për-gjith monë...

O Virgjëreshë e vetme e kulluame dhe e pangarë, çë linde Perëndinë pajt'Shpirtit Shejt, ndërmjetò sa të shpëtonet shpirti i shërbëtorit t'ënt (e

shërbëtores t'ënde) (sa të shpëtonen shpirtrat e shërbëtorëvet t'ënt.

Kijëna Lipisî, o Perëndi, pas të madhes lipisî s'ate, na të parkalesiëm, Ti gjegjëna e kijëna lipisî.

Lipisî, o i Madh'in'Zot.

Pameta parkalesiëm t'ën'Zonë për prëhjen e të vdekurit shërbëtorit (e të vdekurës shërbëtores) (e të vdekurvet shërbëtorëvet) të Perëndis e sa ti ndjejë gjithë ftesat të dashura dhe të padashura.

Lipisî, o i Madh'in'Zot.

Sa i Madh'in'Zot, Perëndia jinë të vëjë shpirtin e tij (e saj) (shpirtrat e tire) te ku prëhen të drejtët; lipisit e Perëndis, rregjërinë e kjielliavet e ndjesën e mëkatëvet të tij (të saj) (të tire) Krishtit Perëndi dhe Rregjit t'ënë të pa-vdekur le t'i lipiëm.

Ipna, o i Madh'in'Zot.

Parkalesiëm t'ën'Zonë

Lipisî, o i Madh'in'Zot.

O Perëndi i shpirtravet e i kurmevet, o Ti çë shkele vdekjen e çë munde e shtipe diallin dhe i dhe gjellë gjithë jetës; Ti, o i Madh'in'Zot, jipi prëhje shpirtit e shërbëtorit t'ënt të vdekur (e shërbëtores t'ënde të vdekurë) (shpirtravet të shërbëtorëvet t'ënt të vdekurë) në vent dritie, ne vent gëzimi, në vent drosie, te ku ngë isht dhëmbim, hidhërim dhe psherëtim; ç'do mëkatë çë ka bërë me fjalë, me të bëmë e me mendje, ndëjeja si Perëndi e mirë çë je e çë do mirë njerëzit; se ngë isht njeri çë rron

në jetë e ngë mëkatron, se Ti je vetëm i pa-mëkatë; drejtësia jote isht e drejt për gjith-monë e fiala jote isht e vërtetë.

Se Ti je ngjallja, gjella dhe prëhja e shërbëtorit t'ënt të vdekur (e shërbëtores t'ënde të vdekurë) (të shërbëtorëvet t'ënt të vdekurë) o Krisht Perëndia jinë e na Tij dërgojëm lëvdi bashkë me Atin t'ënt të pa-zënë fill, bashkë me gjith-shejtin Shpirtin t'ënt të mirë e gjellëdhënës, nanì e për gjithmonë e mbë jetë të jetëvet.

- *Ashtù kloft.*

Jipi prëhje, o Zot, shpirtit të të vdekurit (vdekurës) (shpirtravet të të vdekurvet) të krështerë ortodhoksë, në vent të shejt e në horë të të drejtvet, prit atë shpirt (atà shpirtra) o Shelbues, e jipi prëhie.

Lëvdì Tij, o Krisht Perëndi, shpresa jinë, lëvdi Tij.

- *Lëvdì past.....*

O Ti çë ke fukji ndër të vdekurit dhe të gjallët, si Rrekj i pavdekur dhe çë u-ngjalle së vdekurish, o Krisht'i vërtetë Perëndia jinë, për parkalesitë e së pangarës Mëmës së Tij, të Apostojvet të shejtë, të lëvduar dhe embër shkëlkjier, të Atëravet t'anë të ndershëm e theoforë e të stëratëravet të shejtë e të lëvduar, Avràm, Isak dhe Jakob, të Shejtit Llazar i dashur'i Krishtit çë e ngjalle pas katër ditë dhe të gjithë Shejtravet edhe shpirtin e shërbëtorit të tij (e shërbëtores së tij e shpirtrat e shërbëtorëvet të tij) çë u-ndanë prej ne tue

ndruar gjellë, e (i) vendostë në horën e të drejtëvet e i dhëfshit prëhje në gji të Avramit dhe e nëmërofshit (i) ndër të drejtët e neve na patçit lipisì, si i mirë çë ë e do mirë njerëzit.

- *Ashtù kloft.*


- I përjetshëm kloft kujtimi (i tij-i saj-i tire).




Lazëri

O mirë mbrëma, - ksâj zotëri,
çë ndë ktë shpî - ndodhet, u thom,
Gjë, çë famasmë - bë Perëndia,
tek ajo horë - ç'i thon' Betnia.
Ish'një njerî - ç'i thoshiën Lazër,
nga Krishti i dashur - me lipisî.
Dî mostra kish' - vetëm'è jo më,
me varfëri, - è pa mosgjë.
Lazëri vdikj, - se mortia e mbiodhi,
è dyke klâr - zëmbra ju loth.
E varrëzuan - tue shkulur krip,
mirë e pështruan, - è u vûn në lip.
Te Perëndia - u nisn'e vanë;
me lot'ndër sî - muarn'e thanë.
O Zot, o Zot, - në kishe klënë,
vdekur'ng'e kishëm - vëllauthin t'ënë.
Fshini atò lot, - pliksni atà krip,
E çë na thua, - o i madh'in'Zot?
kâ kâtrë dit' - çë vlau ha bot.
Mua kimni bes, - sè U jam Gjella,
U Perëndia, - U vetm'in'Zot.
In'Zot u nis, - me Apostoit ish'
gjindja ç'e prisiën - me dishirim.
Posa ç'arrû, - nga varri u kjas,
Lazërin thirri, - me një zë t'math.
O Lazër, - ngreu e rrëfiej
çë vien me thënë - kjo mortie e shkret.
mos kini drê, - se Lazri flê.
Lazëri u ngre, - sè u ngjâll'pamet,
è i tha shum vjet' - të Lartit Zot;

E prân i tha: - o i Madh'in'Zot,
çë farmak'i math - ç'isht ajò bot!
Gjith'e famasur, - gjindia kjëndroi,
Krishtin vëldoi - si Perëndi.
Ktë të vërtet - V'angjeji e thot,
streksi në jet' - kur jitsëj in'Zot.
Njeriu çë rron - me shejten bes,
me gëzim vdes - è pâ kopos.
O ju ç'na gjegjij, - patçit harè,
èjani, sbllini, - bierni atò vê.





KENGEZA ISUTHIT NE SAKRAMENT

Zot i math

I

Zot i math'i të tërës jêtë
Jê si dielli brënda rês;
Po te Buka, me t'vërtetë
U të shoh me sît e fês.
Eja, o Zot, tue prur bekime
Te kî gjî çë të thërret
Eja shpejt e zëmbrës t'ime
Bjeri pakjë edhè shëndet.

II

I përmisur e pa fialë
Rrî përpara Teje, o Zot,
Më ndëjê e të klofsha falë
Për gjith-monë, ashtù si sot

III

U ngah Ti çë do të mira
Po pres, o Krishti i jimë
Bënëm zëmbërën e dëlirë
Jetën ëm të pa mbarîm.

Për kungimin

I

Ashtù si kjasem, dridhem;
Një drit'Parraisi û shoh;

Sa i math' jê, o Zot, u njoh,
Sa i miêr'ë shpirti jîm.
Eja, o Krisht, eja
Shpejt, eja, Isuthi jîm;
Eja, o Zot, eja
E shejtërò, Tî shpirtin t'im.

II

Eja, eja, Isuthi jîm,
I zëmbrës jê shërtimi,
I shpirtit jê pastrimi:
U po Tij dishironjë.

III

O Isuth i mirë, pa eja,
U t'pres te zëmbra jime,
U po Tij thres nga thrime,
O gjella e shpirtit t'im.

U të falem

U të falem e t'lëvdonj
Si të kam te gjiri i jim;
Bashk me kjiellin të këndonj
Më të bukurin këndim.
Çë jê i madhi!
Çë jê i miri,
E sa mirë mûa më do!
Sa ë dhurata, akjë edhè hiri
Kloft, o Zot, e m'e pranò.

II

Edhe vet, o Zot, të dua,
Më çë vete e koha shkon;
Mos më le e po rrî me mua
Se po Ti më lumëròn.

III

Kur tek Ti të vinj ndë vonë
U Të pafsha ashtù si jê,
Pa mbulès, e për gjithmonë
Të lëvdofsha me harê.

Të Përujem

I

Të përujem, Flijë Shejte;
Flijë e s'Lartës Dashurì;
Ti jê e kjiellit psherëtimi
Nderi i t'tërës njerëzì.
Të përmisem Flijë Shejte,
Flijë e s'Lartës Dashurì.

II

Të përujem, Flijë Shejte;
Flijë e s'Lartës Dashurì;
Ti jê i trimavet gzimi;
E e të grimòsurit fukjì.
Të përmisem.....

III

Të përujem, Flijë shejte;
Flijë e s'Lartës Dashurì;
Ti i të gjallëvet shëndeti;
Je shpresa në hjidhî.
Të përmisem.....

Eukaristis

I

Përpara Flijës Shejte,
Ndihem i plot me bes,

E zëmbëra jime dhizet,
Kur Zotin Krisht û thrres:
O Isuth te Buka i fshehur
Ti rrî gjith'mon'për nê,
Me bes û Tij të falem
Se Rregji i kjiellit jê.

II

O Flijë tri hêrë shejt,
Pakja e shpirtit t'im
Përpara Tij përmisur
U thrres me dishirim:
O Isuth.....

III

O Flijë, Buka e kjiellit
Kurm e Gjak të Krishtit Zot
Eja, eja te kjo zëmbërë
Çë të pret me bês e thot:
O Isuth.....

Isuthit në sakrament

I

Isuth, Isuth i dashur
Pastrò Ti zëmbrat t'ona
Ushkjimin shejt dhurona
Bukën e dashuris.
Isuth, Isuth, Isuth
Gjella jonë Ti je
Ti rregjërò mbi ne

II

Isuth, Isuth i mirë
shpresë tek Ti na kemi

se bijt e tu na jemi,
O Zoti i lipisis.
Isuth.....

III

Isuth, Isuth i t'ëmbël
gjith njerëzit t'lëvdojën
gjith zogazit këndojën
me mirënjohie e gëzim.
Isuth, Isuth...

Të pasosmit Zot

I

Të pasosmit Zot të krështerë,
Po me këngat t'i çojëm lëvdim,
Esht i fshehur në buk e në verë
E na jipet si i shpirtit ushkjim
E përmist e me fakjen te dhêu
Tufa e bijëvet të falet me besë
Për fajtorët, çë gjaku shpërbleu
Kij të dhëmbur e derdhi ndëjes.

II

Në pështrimit prej gruri t'përkrijem
Mbi të lartin e të ndritmin thron
Nga gjith Engjëjit Mbreti i shërbiem
Kto zëmbra t'ona pushtòn.

III

Perëndi çë nga Buka e bekuame
Për të dashur e pakje na flet,
Tek Ti shpërëjëm në jet t'helmuam;
Se pas luftës dot'kemi shëndet.

KENGEZA ZOTIT KRISHT

Na duam t'ën'Zonë

I

Na duam t'ën'Zonë, Virgjër' e lume
fjalëvet t'ona pa vëri vesh
na të thërresiëm me besë, o Mëme,
mallin e thellët ti bën-na shesh
Mëme, na fal uratën
è gjekj kë të thërret.
Na duam t'ën'Zonë, t'e kemi tatën
na duam t'ën'Zonë, t'e kemi mbret.

II

Na duam t'ën'Zonë brënda te shpia,
e duam në zëmbrë të gjith gjërîs
të jemi dhezur nga dashuria,
nga ziarri i flakët i Perëndîs.

III

Na duam t'ën'Zonë në vent të mësimit
atjè të dzëhet si t'dzëhet isht
e larta flalë e njerëzimit
me shejtin embër të Zotit Krisht.

Lutëje të mbrëmës

I

Zot i math, ù bie të flëë,
E'ngë di në u gdhefsha mëë;
Shpirtin t'im ù tîj t'e lëë.

II

Jam e ngulem te ky shtrat,
E' më ruan in'Zot si At.
Po në vdeksha te kjo natë,
Falmë, o Zot, çë do mëkatë.

III

Em uratën, Zoti Krisht;
Em uratën, o Mërî;
Ti bekomë, o Perëndî.

Përdëllim madhit Perëndi

I

O i pâ-sosmi Perëndî,
O i pushtetshmi i madhi in'Zot,
U të ljpinj lipisî,
Tuke derdhur syyshit lotë.
Ndjena, ndjena, i madhi in'Zot

II

Kûr mëkatën ù llojàs,
Helmit zëmbra m'blonet plot;
Po m'gënjén i bushtri gas,
E't'fëjénj, o i madhi in'Zot.
Ndjena, ndjena, i madhi in'Zot

III

Psherëtînj me t'math tërbim,
Sè t'kam ftesur shumë mot;
Po kâ t'shkulet shpyrti i jim,
Se t'fëjénj më para, o Zot.
Ndjena, ndjena, i madhi in'Zot

IV

Rrofsha edhè në varfërî,
Ndêr mos patça è porosî;
Po ti kijëm lipisî;
Mos më le në faj, o Zot.

Ndjena, ndjena, i madhi in'Zot

Lipisî, o Zot

I

Lipisî, o Zot! na gjith të parkalesiëm
të ruash nga armikjët t'dashurin Atdhê.
Ruana edhè neve, gjegjëna se të thëreslëm,
O i Madh'in'Zot! Shelbuesi jinë jê.

O zëmbra e Isuit, je flaka e dashuris
Të thresiëm na ndër helme
burim i lipisîs.

II

Lipisî, o Zot! për gjith të mëkatruamit
çë ligjën t'ënde shkeliën nat' e dit';
te dhromi i drejt, si bij, ndër të bekuamit
Ti thirri, o Krisht, è gjithve jipi drit!

Osanna t'in Zoti

I

Osanna t'in Zoti! me zëmbër na thomi
Na Flijën e pakjes në gji dishirojëm
Na bukën e kjiellit me besën kërkojëm
P'ushkjim sâ t'e kemi të gjellës te dhromi,

O Krisht për gjithmonë, si diè edhè sot
Ti je Rregji jinë, Ti vetëm in'Zot.

II

Osanna, osanna! vëldojëm t'ën'Zonë
Se Kurmin e Gjakun na là për të ngrënë
Për gjellën e shpirtit, kur foli tue thënë
Kush ha nga kjo bukë ai rron për gjithmonë.

O Krisht.....

III

Për gjellën e gjithve nga kjielli u-sdripe
O Flijë e përshejte, e na prure shëndetën
Ti jerdhe ndër gjinde è lirove gjith jetën
Nga sgjedha e mëkatës è të ligun e shtipe.

O Krisht.....

Gjith lëvdojëm

Gjith lëvdojëm, gjith bekojëm
Krishtin Rrekj dhe Perëndî,
Ngrëjëm zërin e këndojëm
Se na pati lipisî.

U të falem kurdoherë,
Zoti Krisht i bër njerî
U të shoh si buk e verë
Po të lut si Perëndî.

II

Ai në jet u sdrip nga Kjielli,
Mori kurm e u bë njerî;
Te ku lint, ku shuhet dielli
Je me ne në Eukaristî.

U të falem.....

III

Gjith lëvdojëm, gjith bekojëm,
Krishtin Rrekj'dhe Perëndi
Ai për nê, mos e harrojëm
Jerdh'e leu si një mavri.

U të falem.....

Gjith lëvdojëm

I

Gjith bekojëm Krishtin t'ënë
Çë klê vunë ngrikj për nê;
Gjith bekojëm na tue thënë
Rregjërrofshe, o Zot, mbi dhê.

Mos e shajëm më t'ën'Zonë
Mos e nëmiëm Zotin Krisht
Se për jet' è për gjith monë
Kush e nëm i nëmur isht!

II

Gjith bekojëm, të krështerë
Shpirtin Shejt si Perëndi;
Gjith bekojëm na nga herë
Të pasosmen Dashuri.

III

Gjith bekojëm Perëndeshën
Zonjën Mëmë e Shën Mëri,
Gjith bekojëm Virgjëreshën
Tuke i lipur lipisi.

Isuht

I

Isuth ndrit mendien t'ime:
Shkëlkjefshit drita jote brënda meje,
Vetëm ashtù do t'vinjë û ndër gzime
Tek ajò jêt hareje.

Ti drita jime je
Ti ndritëm, o Isuth.

II

Isuth, dhis zëmbrën t'ime:
Dhize me flakën t'ënde të pasosme;
Vetëm ashtù ngë do t'jet gjella jime
Nga mëkata e plakòsme.

Ti flaka jime jê.
Flakëromë Ti, o Isuth.

III

Isuth, dzâ gjellën t'ime;
Te duart t'ote mirre Ti për gjithmonë.
Vetëm ashtù mëndë t'rronjë û pa helmime.
Te e shkreta jeta jone.

Ti gjella jime jê,
I dashuri Isuth.

Jisuthi jim, me një tërkuzë

1) Isuthi jim, me një tërkuzë
Si kusarë, kush të lidhi?

Kleva u i pazëmbrë
Isuthi jimë, të lip ndëjesë.

2) Isuthi jim, atë bukurë fixhë
Kush të rahu pa mëshirë?
Kleva.....

3) Isuthi jim, gojën e t'ëmbël
Kush me uthull të hidhëroi?
Kleva.....

4) Isuthi jim, mbi atà krahë
Kush krikjen të nglakoi?
Kleva.....

5) Isuthi jim, duart të shejt
Kush me gozhda po t'i shpoi?
Kleva.....

6) Isuthi jim, këmbët të lodhët
Kush ndë krikj t'i mbërtheu?
Kleva.....

7) Isuthi jim, atë zëmbër të dashur
Kush me shtizën po të shpoi?
Kleva.....

8) O Mëri, atë Bir të bukur
Kush e plagoi e kush e vrau?
Kleva u i pazëmbrë
O Mëri, të lip ndëjesë.

O zëmbra e t'madhit Zot

I

O zëmbra e t'madhit Zot,
Burimi i lipisîs
Me ziarr të dashurîs
Na dhis e flakërò.
Isuth! Isuth! Isuth!
Me mall na përvëlò
Isuth! Isuth! Isuth!
Me t'dashur na thiellò!

II

O zëmbra e t'madhit Zot,
Për njerëzit shëndet;
Nga i ligu, çë na nget;
Na ruaj' e na shpëtò.
Isuth...

III

O zëmbra e t'madhit Zot,
Çë jep fukjì e durim;
Kûj ndodhet në udhëtim
Te Kjielli na drejtò.
Isuth...

Rri me ne

I

Në llargu nesh Ti vete,
Më t'errët mendiet t'ona, o Zot, kjëndrojën,
Ngë kemi t'jer'ndër helmet e ksaj jetie,
Çë dhromin na dëftojën
Veç Tij, o mëshirë-plot.
Rri me ne, o i Madh'in'Zot.

II

Vetëm nga Shejtia Krikje,
Vien zëri çë mënd'gzonj shpirtin t'ënë,
Nga Druri Shejt ku, o Zot, durove e vdikje,
Ti gjellën na ke dhënë,
Ashtù si diè edhè sot.

Rri me ne, o i Madh'in'Zot.

III

Eja, Isuth gjith i mirë
Dhiz'me dashurin t'ënde zëmbrat t'ona
Bukën e Kjiellit ndaj te kjo errësirë,
Bekimin t'ënt dhurona.
O Isuth, për jet e mot.

Rri me ne, o i Madh'in'Zot.

Krishtit Rrekj

I

Rrekj i Kjiellit çë jerdhe te jeta,
Si njerì ndër mes neve Ti rrove,
Vapkëzìn edhè mortien durove,
Sa t'na jipie shëndet e shpëtìm.

Rregjërò rregjërò mbi ktë jêtë,
Rregji i rregjëravet, Krishti i vi.n ngrikj.

II

Rregji jê i dashuris: po sa shkove!
Si kusar' kleve vierrë mbi një Krikje.
E për ne derdhe gjakun e vdikje,
E për ne dhe të sprasmin shërtìm.

Rregjërò...

III

Rregji i helmevet, Krikjen nglakove;
Glëmbash pleksur'të vun'një kurorë,
E për të kjeshur një kallmë në dorë,
E sa rìejte me pakjë e durìm.

Rregjërò...

Shpirt Shejt

Eja, o Shpirt è Perëndì,
Përvëlomë ti ktë gjì;
U t'përes me dishirìm,
Shejtëromë shpirtin t'ìm.
Eja, o Shpirti Shejt i jim,
Eja è ndrite shpirtin t'ìm.
Flakë e gjallë e Shpirtit Shejt,
Dhizëm zëmbrën t'ime shpejt.
Eja, o Frymë e Parakletë,
Ngushëllomë me t'vërtetë.
O parrais i shpirtit t'ìm,
Mblomë zëmbrën me gëzìm.
Dritën t'ënde, o Shpirt, dhurona;
Dhis me ziarrin zëmbrat t'ona.

Për të vdekurit

I

Parkalesiëm për shpirtrat e mirë,
Çë te ziarri me pakje durojën
E çë presiën ndër lot me dëshirë
Te Parraisi të shkojën me gzim.

Zoti Krisht, na të thomi për dita:
Jipi ndjesën Ti prëhien dhuroi;
Te ku mblen e pashuashme drita
Për gjith-monë atà klofshin të lumë.

II

Atà shpirtra t'ën'Zonë dishirojën,
Perëndin atà thresiën gjith-herët,
Perëndin atà vetëm kërkojën,
Te Parraisi do t'gjejën pushim.
Zoti Krisht...

III

Po sa rîejën se ng'shohiën t'ën'Zonë!
Sa shërtime nga zëmbrat dajën!
Nat'e ditë pa u lodhur po thonë:
Shuana, o Zot, ktë të math'dishirim.
Zoti Krisht...

KENGEZA SHEN MERIS

O Mburonjë e Shkjipëris

I

O mburonjë e Shkjipëris,
Virgjëréshëz'e dëlirë,
Mëma e lartë e Perëndîs,
Çë na jep këshill të mirë;
Ti çë ruajte Gjyshrat t'anë,
Të mos birjën shejten besë,
Te ku ndodhen edhe janë,
Arbëreshvet kîj kujdés.

II

Kîj kujdés për nê të mjerët,
Zokj të varfër jasht furrikut
Kîj kujdés për atà t'jerët
Çë po vuajën nën armikut.

III

Sâ t'i falemi t'in'Zoti
po me gluhën çë na dha;
Po si i falej Kastrioti
e gjëria nga zbresiëm na.

IV

Prân, o Mëme, me të mirë,
Lutjen t'ënë ti digjò;
Mos na le ndë të vështirë,
E kûrr-kûrr mos na harrò.

Prir sit mbi jetëzën

I

Prir sit mbi jetëzën
o e madhia Zonjë
Se sot e gzuame
Dot të t' nderonjë

Edhe u i gëzuarith
Thom me harè:
Shën Mëri e 'Dhitries
Parkales për ne.
O Mëmëza jonë
Lutu për ne.

II

O mëmë e ëmbëlë
E butë è e mirë
ti për gjith njerëzit
ke mëshërirë.

Ti për të dashurit
të mira ke:
Shën Mëriza...

III

Te gjella e luftavet
Gjith kurdoherë
Tij po të truhemi
Na të krështerë:

Se shpresa e gjithëve
Sè ndihma je
Shën Mëriza...

Shën Mëris Odhijitrie

I

Tij, o Virgjër Odhijitrie,
O Mburonjë e Horës t'ënë,
Na ngë lodhemi tue thënë
Ruana besën, o Mëri.
Atë bes ç'patëm lënë
Nga atà gjishra plot me nder
Çë si trima e si t'krështerë
Shum luftuan me turkun zi.

Eja, o Mëme, o Perëndeshë,
Eja, o Zonjë e Shën Mëri,
Si të krështerë dhe si Arbresh
kijëna gjithve lipisì.

II

O ti Virgjërë Odhijitrie,
Çë ke klënë ndihma jonë,
O ti, Mëme, çë t'ën'Zonë
Jerdhe linde e pa mëkat:
Bëna Ti neve të na vinjë
Drita e shpirtit lart nga kjielli,
Si nga shkrep edhè nga dielli
Drita e dritës nga menat!

Eja, o Mëme...

III

Tek Ti, Virgjërë Odhijitrie,
Tek Ti, priremi e po thomi:
Të ksaj gjellëje te dhromi
Jipna drit edhè fukjì.
Na fukjì e drit kërkojëm
Sa të rrojëm te kjo jetë

Po me besën e vërtetë
Në të lartin Perëndì.
Eja, o Mëme...

Falem Mëri

I

Falem Mëri, i të mjerëvet pështrimi
Ti shpres'e gëzimi e të helmuamvet je
Tij na t'thërresiëm, o i hirevet burim
O Mëm'e dashur parkalès për ne.

O Mëma jonë me ne të mierë
pajtò t'ën'Zonë-Falem.

II

Falem Mëri, çë rregjëròn te kjielli
e të krështerëvet ti ndihma je
dritën e shpirtit jipna Ti se je dielli
çë nga Parraisi dritën shkrep mbi ne.

O Mëma jonë...

III

Falem Mëri Ti fukjia jon ke klënë
Zonja e Parraisit, dreja e Pisës Ti je
nga i ligu ruana, o Mëme, shpirtin t'ënë
O Mëm'e dashur parkalès për ne.

O Mëma jonë...

Ndëpër lulet

I

Ndëpër lulet çë na mbjodhëm
Me duart t'ona në menatë
Bija t'Zonjës s'pâ-mëkatë,

Harê è gas do t'bëjëm sot,
E të gjitha do t'zëëm kënkën,
Po si zëmbëra na e thot.

II

Me zëë t'ëmbël è të lart,
Tij, o Zonjë, do t'këndojëm,
Tij, o Mëme, do t'lëvdojëm,
Ç'akjë neve mâll dëftòn.

III

Nndër të véshura të bardha,
Gjith'përpara tîj nà rrijëm
E të faleshim si dijëm,
Kûr bëëm bên çë na gëzòn.

IV

Ndërmès tymit të livanit,
Ndërmès dritës, ti vështroje
Me një gas, é na diktoje
Perëndìs ç'u lê ndër jetë.

V

Gjêr çë prân te i larti kjiell,
Rrethur kriet me një kurorë,
Me një degë ullî në dorë,
Gjith' të vijëm ndë gëzim.

Fatima

I

Zonj'e madhe e Perëndeshë,
Mëma jonë na të thomi,
I Parraisit Ti je dhromi,
Zonj'e lume e Virgjëreshë,

Falem, falem, falem
Mëma e Perëndis,
Falem, falem, falem, zëmbra jon këndon.

II

Mëma jon Ti ke klënë
Ndër të kekje e ndër të mira,
Ti je shpresa dhe ëmbëlsira
Gjella e gzimi i zëmbrës t'ënë
Falem, falem...

III

Në Parrajs ku e lume rron,
Ke kujtuar se bij na jemi,
çë tek Ti pështrimin kemi
e me kjiellin na pajtòn.
Falem, falem...

Zonj'e sgledhur

I

Zonj'e zgledhur je Ti, Virgjëresh,
Nuse Mëm' edhe bijë e t'in'Zot;
kjiell e dhè të këndòn Perëndeshë;
E hirë plota e lëvdoshme je Ti.
Më se hënza e se dielli,
Llambaris Ti te kjielli
Me t'ën'Zonë për gjithmonë
Mbi gjith grat bekuar je Ti.

II

Je m'è bardhë se drita e menatës
Je m'è hjieshme se lulet e fushës;
E në vërrejëm gjith'izet e natës,

Ngë janë ize të bukur si Ti.
Më se hënza...

III

Atò buzë çë puthën t'ën'Zonë
Vur më gas e përgzona ndër helme
Se ndër helme na shkon gjella jonë
E gzim vetëm na gjejëm tek Ti.
Më se hënza...

O Zonj'e Parraisit

I

O Zonj' e Parraisit
e bukura Mërì,
Të lume të thonë
Në jetë gjith njerì
Falem Mërì - Falem Mërì.
Nga fushat, nga malet
Nga dejti, o Mërì,
gjith jeta të falet
Me kënka e lëvdi-Falem Mëri.

II

E lulet e pemët,
E dashura Mërì,
E bari përjashta,
Të japiën lëvdì
Falem Mërì....
Nga fushat.....

III

E dielli me hënzën,
Edhè izet, o Mërì,

Të rrin si kurorë
Të japiën lëvdi - Falem Mëri...
Nga fushat.....

O Zonj' e madhe

O Zonj'e madhe falem
Falem, o Mëri;
Ti rregjëròn mbi jetën
O Virgjërë Mëri;
Tij Odhijitrie, Mëmëza jonë,
Thomi për gjith monë:
Falem, falem, falem Mbretëresh.

Shën Mëris

I

Shum e dashura Mëri
Ti më gas, ktu ku jam,
Më vërren me dashurì,
Se t'ët Bir te zëmbra kâm.
Ç'ësht e lumeja kjo herë!
Ç'ësht e bukura kjo ditë!
Zëmbra jime e shkret, e mierë
U bë thron'i t'Lartës Drit!

II

U tek Ti, o Mëri, kam besë,
E si birë të lutem sot;
Ti për mua po kij kujdes,
Të kem hir nga i madh'in'Zot.
Ç'ësht e lumeja...

Sa mirë të dua Mëri

I

Sa mirë të dua Mëri,
O Zonja e zëmbrës t'ime,
Ngak Ti burrojën gëzime
Tek Ti dot gjenjë gëzim
Kam vatur tue rahur
Prapa të rremes jetë
Po kam u i shkretë
Glëmba dhëmbim e helm.
Tij vetëm, o Virgjëreshë
U dua mirë nanì,
Vetëm, o Mëri, tek Ti
Kjò zëmbër gjen pushim.

II

U pakjëjen kam kërkuar
Te jeta ndër pëlkjime,
Çë shkojën te një thrime
E zëmbrën na lën të prer.
Po vetëm, Zonjë e madhe
Ndurìs dashuria jote
Për sâ dot shkojën mote
Mëma jonë Ti jê.
Tij vetëm...

Jipna pakjëjen

I

Te kta helme e ndër mjerîme
Zonj'e madhe e Mëmëza jonë

Ti pajtona me t'ën'Zonë
Se na jemi bijt e tû.

Jipna pakjëjen, o Shën Mëri,
Kijëna, kijëna lipisì.

II

Ç'kurë na prure, te kta vende
Na ke ruajtur te gjith herët
Tij të truhemi nâ të mierët
Përposh shpàgarit na vû.

Jipna, pakjëjen...

III

Tek Ti priremi, o Virgjëreshë,
kurdoherë te vzonjët t'ona;
Pàkjëjen, eja, Ti dhurona
Jipna neve Ti ktë gëzim.

Jipna pakjëjen.....

Parkalesi

Të parkalès, o Mëma jime
Të më bekòsh nga kjielli
Zëmbrën e Shpirtin t'im.

Me bar e me lule

I

Me bar e me lule
Gjith jeta pështronet,
Nanì të këndonet
E jëma e t'in'Zot!

Mëri, Mëri të falem Mëri.

II

E lehta puhjizë,
I bukuri diell,
E zogat në kjiell
Na grishëjën sot.

Mëri...

III

O e dashura Mëmë,
I lum ai bir
Çë shpirt të dëlir
Të fal e ngushtòn!

Mëri...

IV

Si zok te foleja,
Nën shejtes mbulesë,
E mban, è ndëjesë
Nga i Larti i fitòn.

Mëri...

V

O Zonjë e pushtetëshme,
Kush mënt' t'e ndishkonjë?
Kush mënt t'e dëmtonjë,
Atjè te ku jet?

Mëri...

VI

Armiku i t'in'Zoti
Përpara të dridhet;
Nëmsohet è hidhet,
Me t'ikur kërset.

Mëri...

Zonjë e lartë

Zonjë e lartë, o shpresa e jonë,
Kîj kujdès të math për nê;
Mos harrò se mëmë je,
E' pajtona me t'ën'Zonë.

Nga parraisi kurdoherë
Syyt e bukur'prir mbi nê,
Rrîm pâ tîj ndë frikë e drê,
Me tij rritet shpresa e jonë
O Mërì, pajtò t'ën'Zonë.

Në na ndênshe dorën t'ënde,
Ndër rrëzikjet te ky dhê,
Një fukjî vërtet të rê
Do të ndìenjë zëmbra e jonë.

Nga parraisi...

Në gudzòn të na ndishkonjë
Drekji i nëmur, si ndë hjê,
Përpòsh skjepit, ti na kê,
S'do të dridhet zëmbra e jonë.

Nga parraisi...

Mos na le te hera e luftës,
Mos harrona è vurna'rê;
Tek e màdhia kuturê,
Dhimësò për ne t'ën'Zonë.

Nga parraisi...

Me atë ndihmë è me atë dritë,
Çë na jep te e zeza rê,
Do të vijëm ndë harê,
Te Parraisi për gjith-monë.

Nga parraisi...

Sa i plot me amli...

Sâ i plot me amlî në zëmbrët
Esht embri i jyt, Mërì!
Një gas i math è i rî
Nga ai më rrjeth è vien.
U tîj thërres, o Mëmë,
Kûr zëë t'agonjë dita,
E kûr e dìellit drita
Në dêjt è n'mal shkëlkjèn.
At'embër fort të dashur
Në frymavet ù shtie,
Kumbimi mua m'e bie
Nga tjatri breg pamèt.
Te vendi shejt i thurur
Me zëë të plot amlî
Këndojën tyyj, Mërì,
Nuset ç'i Isui thërret.
Gjith'njérëzit e botës
Shpërejën të të shohiën,
Sè tyyj për ëmë t'njohiën,
Çë bijt e tû ndihmòn.

Na faje kemi shumë

Na faje kemi shumë
Armìk na kjiellin kemi.
Nga e liga te ku jemi
Pa kush, kush na liròn?
Uje të hieshmin sî
Mbi dheun, é vurna 'rê;

O Zonja e Shën Mëri,
Kîj lipisî për nê.

Anis, çë hekj ndër valat
E dêjtit të trazuar,
Jê nj'îll i dishiruar,
Çë prëhien i dhuròn.

Të mjerëvet te jeta,
Nga helmet të dënuarë,
Me lidhie të munduarë,
Pa jip lirîn çë sot.

Se prân ndër tufat shejte,
Në kjiell me tîj ndë-vonë,
Do t'thomi për gjith-monë
Lëvdît e t'madhit Zot.

O mëmë, o bijë, o nuse

O mëmë, o bijë, o nuse,
E s'parës Dashurî,
Te kjielli mosnjerî
Kâ nderin çë kê ti.

Me kjozmë e me të mira
Një lum për tîj buròi.
Vërteta i hîrit kroi
E i bukurîs jê ti.

Çë kûr ndë ment i jerdhe,
Të deshi in'Zot te kjielli;
Po ahêr ng'ng'ish dhezur dielli,
Çë na gëzòn nanì.

Në prân a bëre mëmë,
Ti mbetje edhè e pâ-ngarë,
Se faji i mëmës s'parë
Ngë la ndo shenk tek ti.
Besònj se, pâjt së jëmës,
Dhëmbìm do t'kêt për mua,
Çë t'truhem tîj; se krua
I dashurîs jê ti.

Nga gjith'jeta

Nga gjith'jeta, e madhia Zonjë,
Lëvdî patshe për gjith-monë,
Me Shëlbuesin t'ën'Zonë,
Çë mbi dhê na solle ti.

Lëvdì patshe ti ndër nê
Bashk me pemën çë na dhê.

Gjith'kjëronjet për tîj flasjën,
E të tuat lëvdî këndojën;
Gjith atë ç'kê bëër kujtojën,
E të thonë: Lumja ti!
Lëvdì. patshe.....
Çë kûr prindërat e parë
Te parraisi bëën mëkatën,
Taksur tîj si mëmë patën
Të Mesîs çë kish të vij.
Lëvdì patshe.....
Gjêr sâ t'jemi ndër të gjallët,
Dritën t'ënde ti dhurona;
E të hipemi ndihmona
Ku je ti me t'madhin Zot.

Lëvdoni Mërin

Lëvdoni Mërin
O ju të Krështerë;
Lëvdonie ngâ herë,
Se pruri lirîn.

Lëvdoni, lëvdoni
Lëvdoni Mërin.

Si lil e dëlirë,
O Virgjërë, u leve,
Për tij edhè neve
I Larti do mirë

Lëvdoni, lëvdoni
Lëvdoni Mërin.

Në garbët të vetë,
Si bîr, e njerzove,
E ashtù na shpëtove
Nga armiku për jetë.

Lëvdoni.....

Si Zonjë e si nënë
Ti kîjna mëshirë
Te hera e vështirë
Të vdekëjes t'ënë.

Lëvdoni.....

O Mëmëza e jonë,
O Zonja e bekuarë,
Të klofshim të trùarë
Për mot e për monë.

Po rroft Shën Mëria

Po rroft Shën Mëria
Me t'dashurin bîr,
Çë t'anët për hîr
I pruri këtù.
Nga vendet e' tyre
Arbreshët-Shkiptarë,
Të besës luftarë,
I reshti me'të.
Falem, falem, falem Mëri
Falem, falem Mëri.
Për besën e Zotit,
Të pàsurat lanë,
U nisën e vanë
E jikën me'të.
Te nata, si nj'izë
I prîjti me dritë,
E i solli në ditë,
Si' rêzë me'të.
Falem,.....
Ndër fusha e ndër pije,
Ndër malet i shkoi
E dêjtin ndërroi
Ndë sterë për'ta
Nga viset e dashura,
Ku shumë u nderuan,
Ku trima u dëftuan
I shpuri këtù.
Falem,.....
Për vendin e bukur,
Ku vllézërit t'anë

Mbi kjafën po kanë
Armikun nanì.
Ashtù te Parraisi
Përsîllna ndë-vonë
Ku bashk me t'ën'Zonë
E lume jê ti.
Falem,.....

O e bukura Mëri

I
U dua këndonj Mërìn
Kur dita shkrep te kjielli
Edhe kur vete dielli
U tîj të thres, o Mërì (2 volte)
O e bukura Mërì
Ti Mëma e gjithëve jê
Ti lut t'ën'Zonë për nê
Të thresjëm embrin t'ënt.
II
U dua këndonj Mërìn
Më parë se të kjëllonem
E kur me natmet sgjonem
U tîj të thres, o Mërì (2 volte)
III
U dua këndonj Mërìn
Gjith kjiroin çë rronj në jet
Sa prân te jeta e ftet
U tîj të thres, o Mërì (2 volte)
IV
U dua këndonj Mërìn
Kur u te puna vuhem

E prân edhè kur prëhem
U tîj të thres, o Mërì (2 volte)
V
U dua këndonj Mërìn
Ndër helme edhè ndër gzime
Abrënda zëmbrës t'ime
U tîj të thres, o Mërì (2 volte)

O ti Mëmë e madhja Zonjë

O ti Mëmë e madhja Zonjë
Ti ngak u pret dashurì
Eja, eja ktë gjî
Eja, o Mëme, eja, o Mëme, t'rregjërosh
Ndienj u dhezur zëmbrën t'ime
E tîj vetëm dishironj.
Mirë t'dua, o Mëmëza jime
Mirë t'dafsha, o Shën Mërì.
Ti si drita e shkrep menatëvet
Te kjò jetë gëzòn gjith njerì
Si rrëmp dielli te kji gjî
Eja, o Mëme, eja o Mëme, të më gëzosh
Sâ isht gzimi i zëmbrës t'ime
Nga menatë kur t'kujtonj.
Mirë t'dua...
Ti ndër helme e ndër kopose
Zonja Virgjër e Shën Mërì
Pakjen bierëm, n'ktë gjî
Eja, o Mëme, eja o Mëme, t'ngushullòsh
Kur ti zbut zëmbrën t'ime
Gjith koposet u harronj.
Mirë t'dua...

Kur bie te dejti

I

Kûr bie te dêjti, aprapa malit, dielli,
E i vetëm ylli i par shkëlkjen te kjielli,
Të thot kushdò i krështêr, me dashurî;
Falem, Mërì.

II

Të falem, o Mërî, çë je e dëlirë
Si drita e rê, çë shkrepi nd'errësirë;
Ndë kjiell, si kleve tek e poshtra botë,
Ti jê e hîr plotë.

III

Të lume mbi gjith'grât brezat të thonë,
E do të t'thên të lume për gjithë-monë;
Se deshi gjith-njeriu shpërblim të bîj
In' Zot me Tîj.

IV

N'edhè të duket kekj për bijt e mjerë
Çë klân è psherëtijën kurdoherë
Ndër helme e faje, tek i shkreti dhê.
Lutu për nê.

O Virgjërë e pâ-fajshëme

I

O Virgjërë e pâ-fajshëme,
Si i pari rrëmp i diellit;
Ja-kënda dheut è kjiellit
Se ti sundòn mbi 'ta.
Jê mbretëresha e trimavet,
Jê hjeja Ti e grarîs;

I çuari i Perëndîs
Të falet si edhè na.
Të falen kjiell e dhê,
Mërî, çë faj ngë kê.

II

Me t'ëmbëlin sy të bukurith,
Kûr Birin t'ënt ti ruan,
Rrëfên te dora i shuan,
Mënîn e' tîj sbutsòn.
Ashtù te shpirti i njerëzvet
Nga helmet i trazuar,
Nga faji i trubulluar,
Heth pakjen è e kthiellòn.

III

Nga gjith'rrëzikjet ruana,
Te ku na ndodhet skota,
E mos na le te skjota,
Ku gjëndemi nanì.
Të bëjëm na të duhurat,
Dëshirin t'ënt dhurona;
Fukjî te zëmbra shtona,
E thirrna prân tek Ti.

Kûr Shën Mëria

Kûr Shën Mëria,
te e ftohta shpellë,
Ndë natë t'thellë,

Jesuin na dha;
Me shejtet duar,
Mbë krahë e muar,
E përgëzoi
Edhè e këndoi:
Të lut, o Bîr,
Me dashurî,
Si Perëndî,
I jetës Zot.
Çë t'math shërbes
Shoh e kam besë!
Atë çë më bëri
U bëra sot!
Kush mënt t'e thoshëj!
Kje Faremiri
I pâ kufiri
Te djeba rrî,
Si i vogël djalë,
Çë ngë kâ fjalë;
Si edhè një i vapkëth,
Një Perëndî!
Jesuithi i vogël,
O bîrthi i jim,
Dhëndërr è mbret
I shpirtit t'im,
Të truanj fajtorin;
Njeriun të truanj;
Rùaje, si ruanj
U tîj nanì.

Shën Mëria, tue kënduar

Shën Mëria, tue kënduar,
Merr të Birin è e kjëllòn;
E m'i thot mbë të djepuar:
Flëëj, o Bîr, edhè bën ôn.
Flëëj, o i dashur, è mos klâj;
Rri ndë prehërt; mos bën vâj.
Oh sâ i bukur ti më jê;
Oh sâ i hìeshëm, biri i jim!
Syri i jyt më jep harê;
Më mblon shpirtin me gëzim.
Flëëj.....
Dialë i vogël, Zot i math,
Mëë çë t'shoh, më fort të dua;
Rri te gjiri i jim di-tsàth,
Mos shamtîj, në më do mua.
Flëëj.....
Biri i jim, i larti Bîr,
Nanì flëëjmë pâ mendìm;
Mëmës t'ënde bën ktë hîr,
Sè mëë prân s'do t'kem gëzim.
Flëëj.....
Oh sâ helme do t'duronj!
Sâ lavomë te ky gjì!
Thom se ahierna s'mënt të rronj,
Kûr të t'shoh te atò hjidhî,
Flëëj.....
Pa mos klâj, o Biri i jim;
Mëma e jote t'përgëzòn.
Flëëj nanì pâ psherëtìm;
Flëëj, o Bîr, edhè bën ôn.

Rregji jim

I

Rregji jim
Isuthi jim
Dialë i nòkërth
Ndër tëtìm
Jêrdh'è lève
Bër njerì
Te nje kalive
Si mavrì.

Flëj, o Bîr, e mos klaj
Flë, o Zëmbërë, e bën-ôn.

II

Mbi tsa kasht
Te një grasht
Ti jê smardhur
Skur jê jasht
Lipset ziarri
Dçeshur jê
E tëtimit
Vdes për nê.

Flëj, o Bîr...

III

Të përgëzòn
Të këndòn
Mëma jote
Në t'kjëllòn
Nga gomari
E nga një kjê
Me âsht e frîmë
Ngrohur jê.

Këndojëm

I

Këndojëm, këndojëm
Se kjielli u sbëllì
Gjith bëjëm hajdhî
Gjith thomi me gëzìm.

Po rrofshit Isui
Si rrekj e si Zot
Po rrofshit Isui
Për jetë e për mot.

II

O i dashuri Dialë
Nga kjielli për nê
Ti sdripe në dhè
Ndër sborë e tëtim.

Po rrofshit Isui.....

III

O i bukuri Dialë
Ti pakjen dhuròn
Ti zëmbrat na gëzòn
Se prure shpëtìm.

Po rrofshit Isui.....

Një lule u deja t'isha

I

Një lule u deja t'isha
Si lulet, o Shën Mëri
Të bukur rrin te klisha
Të prëhen n'atë gji.

O lule kjiellit Mëri
Ti truajëm Birit t'ënt
Të jem në lumëri
Një lule t'kopshtit t'ënt.

II

U deja t'isha drita
Sa plot me dashuri
Të dhizësha gjith'dita
Përpara Teje, o Mëri.

III

Ndër izet t'isha deja
Çë mblejën mbi kriet t'at
Sa bashk edhè u të mbleja
O Mëmë, dit e nat.

IV

Livani u deja t'isha
Livani çë fluturòn
Sa gzimin u t'kisha
Të vija ku Ti rron.

V

O Zonj'e mbretëresh
Ti gjegj dëshirin t'im
Ti bën, o Virgjëresh
T'kem t'pasosmin gzim.

U të dua mirë

U të dua mirë,
O Shën Mëri,
Ngâ dashurî
Vura tek ti.
Përkrahu teje
U dua të mbetem,
Dua të pushtetem,
Në më do ti.
Parkalès (2 volte)
Parkalès për ne (due volte)
Shën Mbëriza e' Dhitries
Parkalès per ne.
Pa thuaj, o Virgjërë
Me ndêr e hjê,
Në mâll më kê,
Çë do ngak ù?
Zëmbërën vetëm,
Me t'math dëshîr
Edhè me hîr,
Mënt të t'jap ù.
Parkalès.....
Po zëmbërën t'ime,
Çë kâ gëlirë
Përsè e do mirë,
M'e more ti.
Ngjera m'ahierna
O Zonjë, mbê,
Çë, nga kî dhê,
Të vinj tek ti.
Parkalès.....

Bura bê gjellën t'ime të falia

I

Bura bê gjellën t'ime të falia
Bura bê! Te fellsinat e gjirit
Për gjith-monë, Mëris e të Birit.
Shkruajta fjalën è s'mënt t'e harronj.
Do të mbetem te besa e t'in'Zoti,
Fjalën t'ime ngë do t'e ndërronj.

II

Gjithasâjtën gëzìm edhè pakje,
Gjithasâjtën kërkova te jeta;
I kërkova, è mosgjakùn i gjeta;
Tuke rrahur, u lodha më kot;
Vùajta shumë te nj'anë è te nj'etrë;
Tesh u prëëjta è pushova për mot.

III

Si nj'anî ndëpër valat e dêjtit,
Nga thëllimi è nga dredha e përzënë,
Gjêr më sot ndë rrëzik ù kam klënë;
Po te bregu jarrura nanì.
Ti, si nj'îll, o Mërî, më përsolle;
Te limani më thure edhè ti.

Kënkë Shejtes Luçi

I

Na të falemi, o Shejtia Luçi
E rrethuar me dritë të hujnushme
Ti je plot me hîr të kjiellëshme
Ti je gjell'e gzimi i zëmbrës.
Shejtia e dashur nga kjielli na ruaj

Nga armiku çë akjë na do lik
Hora jonë u-zgjofshit e u-ndritshit
Te lëvdia e Shejtravet t'anë.

II

Ti na ndih kurdoherë, o Shejte,
Nga rrëzikjet çë akjë na rrethojën
Na me shpresë të madhe të thomi
Besën ruana e pakjen dhurona.
Shejtia e dashur.....

Kënkë Shejtes Teres

I

O ju vasha zëmbrë bardha
O ju djelm o ju kopile
Lule hidhni e trundafile
Tufa, tufa, Shejtes Teres.
Gjith këndojëm tuke thënë
Shejtes bukur plot vëldì
O Teresa e but e mirë
Ti kto lule prit me gzim.

II

Lule hidhni o të Krështerë
Çë te zëmbrat ju dot rrini
E te këmbët dot'shtini
Tufa, tufa, Shejtes Teres.
Gjith këndojëm.....


III

Ndër hijdhit e ndër të klarat

Çë te jeta na helmojën
Ti të gjithve sa durojëm
Jep pushim, o Shejtia Teres.
Gjith këndojëm.....

IV

Ti na ndih te gjith koposet
Ti je shpresa e gjellës t'ënë
Na ngë lodhemi tue thënë:
Tufa lulesh Shejtes Teres.
Gjith këndojëm.....





HYMNI AKATHIST

I

« Ngâ kjiellia ëngjëlli i parë kle dërguar, sâ të bîj të falat Mëmës e Perëndîs; edhè kur të pâ, o Zot, se more kûrm, me zê ëngjëjish ai kjëndroi i manitur, tue thënë:

U të falem, se pajë t'ënt dot shkëlkjenjë harèja
ù të falem, se pajë t'ënt dot sosënjë nëma!
U të falem, se ti ngrên Adhamin çë râ;
ù të falem, se ti paguan lotët e Evës!
U të falem, lartësî, ku ngë arrên mendim njeriu;
ù të falem, e humbët, e pâ-llojasme, edhè ngâ sît e ëngjëvet!

U të falem, se ti jê i Rregjit throni;
ù të falem, se ti jê è kjêll kë kjêll gjith-kjish;
U të falem, o îll çë na dëftòn Diellin;
ù të falem, o gji i Perëndîs të njerëzuam!
U të falem, se pajë t'ënt njerëzia u përtërî;
ù të falem, se pajë t'ënt Krietàri u bê Kriendull!

« U të falem, Nuse e pâ-nusërte! »

« E' Virgjëresha e Sheite, tue llojasur vetëhên e 'saj të dëlîrme, bën zëmbërë, e i thot Gavriilit: Të pa-përitur zëmbrës s'ime, të pa-përitur mua më duket këta të folë të rî-vo shumë; përsè si më flet mbi të zënit fill të pâ-zënë, edhè tue thirrë: Alliluja?

« E', tue kërkuar t'dîj ktë të vërtetë të pânjohurë, Virgjëresha të urdhuruarit ëngjëll mori e i tha, tue thërritur: Thùajmë ti, si mëndë kurr, pa thuaj, ngâ brëndésha të dëlira, si mëndë kûrr, t'lehet bîr?

E' Asaj, gjith i dreruam, ju përgjékj kështù i dërgùari:

U të falem, pse ti zê fill misterin e Këshillit t'parrëfiem;
ù të falem, o Besë mbi atò çë ndéren pa-folë.
U të falem, se ti zê fill famasmët e Krishtit;
ù të falem, se ti je përmbledhia e dogmëvet t'Atij.
U të falem, o Shkallë e kjielliës, me të çilën Perëndia u sdrip.
ù të falem, o ùrëzë, mbi të çilën njerzit nga jeta shkojën në kjiell.

U të falem, o thavmë e përmëndurë nga ëngjëjit;
ù të falem, se ti munde e shkele diajit me dîsâ vaje.
U të falem, se ngak ti pa-ndëlguarith na u lê drita;
ù të falem, se ngâk ti mosnjerî e dijti këtë mistêr.
U të falem, se ti edhè shkon dìejën e të ùrtëvet;
ù të falem, se ti ndrit mendien e të besmëvet.

« U të falem Nuse e pa-nusërte! »

« Virtutia e t'Lartit ahierna përhjeròi Nusen të pa-nusëruashme për të zënë, e, si një dhe të këndëshim, atë gjî dëftoi me pemë gjithë atire çë duan të kuariën shëndetie, kështù tue mësalur: Alliluja.

« Me Perëndîn në gji Virgjëresha shpeit mori è vate tek Elisabeta. Po kësaj i vogëli ju gëzua, si dhe njohu të Falurit; è Mëmës e Perëndìs ai me brìdhëma e gëzime si këndime skûr po thërisëj:

U të falem, se ti jê degë njî druri, çë ngë véshket kûrr;
ù të falem, se ti jê e pasura njî pemie të pângarë.
U të falem, se ti jê e rrin kë aratìs njerëzit me të dashur;
ù të falem, se ti i jep gjellë Krietàrit e gjellës s'ënë.
U të falem, se ti jê ara çë bin burî lipisije;
ù të falem, se ti jê triesa çë jep burî t'sivàsuri.
U të falem, pse ti bën të ënden ë të lulëzojën

pameta livadhet e gëzimevet;
ù të falem. se ti zëmbravet i dëftòn limanin.
U të falem, se ti jê një livàn i mirë-pritur ndërme-stërsije;
ù të falem, se ti jê të sivàsurit e gjithë jetës.
U të falem, se ti jê dashamirësia e Perëndîs për njerëzit;
ù të falem, se ti jê shpëresa e njerësvet te Perëndia.

« U të falem, Nuse e pa-nusërte! »

« Brënda ndiej si zalî ndër mendime n'dish i ùrti Josef; è u tërbua: sè, pàrthin të dij Virgjëreshë, nanì të llojàs skur ndë nusërì të fshehurë, moj Nuse e pa-ngarë. Po kur dsuri të zënit t'at prej të Shpirtit Shejt, nisi e tha: Aliluja!

II

« E' delmerët gjegjën ëngjëjit të lëvdojën t'jàrdhurit e Krishtit të njerëzuar: è rrodhën skur te Delméri, po e shohiën Atë si një Kjenkj të pa-ngâr, çë kulotëj në gjî të Mëris, kuj, sa t'e nderiën, muarnë e thanë gjithnjë-zë:

U të falem, Mëme Kjenkji e Delméri;
ù të falem, se ti je vath i deleve shpirtullòre.
U të falem, se ti je mburonjë kundra armikjëvet çë ngë duken;
ù të falem, se ti je è sbill dìert e Parraisit.
U të falem, pse kjielliat janë è gëzonen me dheun;
ù të falem, pse dheu bën valle me kjielliat.
U të falem, se ti je e Apòstojvet goja çë ngë kjetet kurr tue folë;

ù të falem, se ti je për dëshmorët zëmërore e pamundurë.
U të falem, se ti je e Besës kjëndresa e patundurë;
ù të falem, se ti je e dhuratës shengu çë mblen.
U të falem, se pajë t'ënt kle dçeshurë Pisa;
ù të falem, se pajë t'ënt na klemë veshur me vëldi.

« U të falem, Nuse e pa-nusërte! »

« Magjinjët, të parit çë pan illin çë i dëftoi dhromin e Perëndìs, i vanë prapa të shkëlkjiemit, edhe e patën si një dritë me të çilën vejën tue kërkuar Rregjin të pushtetçëm; e, kur arrûn tek i pa-arrëshim, u gëzuan e Atij zun t'i thërrisiën tue kënduar: Aliluja!

« Të bijët e Kaldenjëvet pan më duarë së Virgjëreshës kë me duarë gjeshi njèrëzit è tek Ti llojasën të Zotin, çë edhè mori fitirë shërbëtori; e u anangàsën t'e ndériën me dhuretì e të thërrisiën edhè së Bekuames gjith një-zë.

U të falem, o Mëmë e illit çë ngë perëndòn;
ù të falem, se ti je të shkëlkjiemit t'asaj dritie mistike.
U të falem, se ti shùajte ziàrmin e gënjeshtrës;
ù të falem, se ti po ndrit dsënësit e misterit e Trinîs Shéite.
U të falem, se ti përzure nga pushtètia e'tij të mizùarin armik e njeriut;
ù të falem, se ti dëftove Zotin Krisht, dashamìrë të njeriut.

U të falem, se ti na shpërbleve nga feja barbare;
ù të falem, se ti na rùajte nga veprat të pugéra.
U të falem, se ti je e ndal lútëjen e ziarrit;
ù të falem, se ti je e na shuan flakën e pesimevet.
U të falem, se ti je e të besmëvet ùdha çë kjêll në urtësì;
ù të falem, sei ti je harèja e gjithë jinîvet.
« U të falem, Nuse e pa-nusërte! »

« E' Magjinjët u bën letçitësë të perëndishmë, kur u pruartin në Babilonë. Atà ruajtin të thënën t'ënde, e gjithëve ligjëruan Tij si Krishtin Zot, tue lënë Erodhin, skur të marrë trush, pse ngë dijti të këndòj: Aliluja!

« Ndë Egjipt mënd'è shkëlkjéu drita e së vërtetës è ndiéke të érrëtit e së rrémes; pse ìdhujit e'saj ran, se ngë mëndëtin përpara fukjìs t'ënde, o Shpëtùesi i jinë: kështù atà çë liròneshin, Mëmës e Perëndìs po thërrisiën tue kënduar:

U të falem, se ti je ùdha e dréitë e njerzëvet;
ù të falem, se ti je përfarònjësa e diàjëvet.
U të falem, se ti shkele të rremen e gënjeshtrës;
ù të falem, se ti të ìdhujëvet sbulóve gënjimin.
U të falem, se ti je Dejti çë mbite Faraonin të shpirtullòr;
ù të falem, se ti je Guri çë të thajturëvet gjéllëje i nzore étien.

U të falem, o Shtillë ziarmi, çë dëftòn dhromin atire çë janë më t'érrët;
ù të falem, o Mburònjësa e jetës më e gjérë sè ajò Miégullë.
U të falem, se ti je të ngrënë si Mana një herë;
ù të falem, se ti je Diakërésha çë dhuròn gëzime të shéite.
U të falem, se ti je Dheu i taksur;
ù të falem, se ti rrieth miàjt e klumësht.
« U të falem, Nuse e pa-nusërte! »

« Simeònit çë ishëj è e lëj këtë jetë të rreme, Ti, o Zot, si i vògëlth, atij i kleve dhënë, por kleve njohur nga aì si Perëndì i vërtet: andai aí u çëmènt për urtërìn t'ënde të pâ-rrëfieme, tue thirrë: Aliluja!

III

« Kriësë të re dëftoi Kriùesi i jardhur ndër ne çë klemë bërë nga Aì, se Aì i bîr në gji të pangar, të pa-ngar, si ishëj, e rùajti: thavmë, çë na tue llojasurë po thëresiëm Virgjëreshën e i këndojëm:

U të falem, se ti je lule së pa-prìshuri;
ù të falem, se ti je kurorë së dëliri.
U të falem, se ti je è shënbëllèn të ngjàllurit;
ù të falem, se tek ti mblen gjella e ëngjëjvet.
U të falem, se ti je e bime me pemë të bukura, nga e çila të besmit kanë gjeghën;
ù të falem, se ti je druri me degë hjesòre, ku disà gjejën pështrim.

U të falem, se ti je è kjêll Kë i dëftòn dhromin atireve ç'e sbieriën;
ù të falem, se ngâk ti u lê Lirùàsi i të lìdhurëvet në mëkatë.
U të falem, se ti je ponìa për Gjìkun të dëréit;
ù të falem, se ti je ndëjésa për disâ të mëkatrùamë.
U të falem, se ti je shpàgëri i të pâ-shpëresmëvet;
ù të falem, se ti je dashurìa çë mun ngâ dishirìm.

« U të falem, Nuse e pa-nusërte! »

« Të tçëméntçimë tue parë ktë të ler të ri të ri, na duam lëm ktë jetë è suvàlëth ngrëhemi tue kjéllurë méndien në kjìell: pse i Larti Perëndì përandài u dëftua në dhe, njerì i përùjëm, përtçë deshi të tilkjëj làrtëzë atà tçë Atij po i këndojën: Aliluja!

« Gjithë e tërë ishëj këtù posht në dhe e Larta Fialë e pa-kuptùame, po ngë u lips fare lart në kjiell: përsè kle një të sdripur t'Perëndis në ktë jetë, po ngë kle si një të ndërruar vent të lerit së Virgjëreshës, e tçìla e marrë nga Perëndia po gjegjej kështù:

U të falem, se ti je vent i Perëndis të pakuptùam mosgjakùn;
ù të falem, se ti je derë e misteri të lùtçim.
U të falem, se ti je ndùhta e ndërdìeme e t'pa-besmëvet;

ù të falem, se ti je vëldia e të besmëvet pandishìm.
U të falem, se ti je kjerri gjith i shéit të Atij tçë jets mbi Kerubinët;
ù të falem, se ti je ndeja Atij tçë isht mbi Serafinët.
U të falem, se ti bashk po ke një gjë me nj'étërë të ndrìshme;
ù të falem, se ti ke bashk è virgjërìn è ëmërìn.
U të falem, se pajë t'ënt u sglith të përvìerrit e njeriut;
ù të falem, se pajë t'ënt u sbill Parraisi.
U të falem, se ti je klìtçi i rregjërìs së Krishtit;
ù të falem, se ti je shpëresa e të mìravet të gjith-motçëme.

« U të falem, Nuse e pa-nusërte! »

« Engjëjit të gjithë u manitën mbi këtë veprë të madhe të t'njerëzùamit t'at: përsè shihiën se, Kuj parthin ngë mëndë edhè njëth t'i kjasej, si Perëndì, nanì Atij bër njeri të gjithë t'i kjàseshin, porsa rroi me ne edhè gjegji nga t'gjithë se thërisiën: Aliluja!

« Gojtàrë me zë t'plotë, përpara Tij, o Mëmë e Perëndis, mùngëra si pishkjë, na shohiëm sè bënen: pse ngë vëlejën të then si Ti je Virgjërë e pate Diàlthin. Por na t'famàsurë për ktë mister, me besë po thresiëm:

U të falem, se ti je një potçër urtësije së Perëndis;

ù të falem, se ti je një arkë e parakujtèsës e 'tij.
U të falem, se ti t'urtëshmit i dëftòn t'paurtësì;
ù të falem, se ti fialë-bëresit i mbarròn si të pa-tru.
U të falem, se pajë t'ënt u lënsuan skjirtùasit e Athinénjëvet.
ù të falem, se ti mblon rriétat e pishkëtorëvet.
U të falem, se ti helkj njérëzit nga honi i padijturìs;
ù të falem, se ti ndrit disà te dijturia.
U të falem, se ti je anìa e atireve tçë duan të gjejën shpëtìm.
ù të falem, se ti je limàni i atireve tçë lundròjën te kjo jetë.

« U të falem, Nuse e pa-nusërte! »

« Zotërùasi i gjithësìs së tërë, pse deshi Aì vet të ruaj këtë jetë, vetëvetìu jerdhi andài në jetë: è si Perëndì ishëj delmer, po pajë t'ënë na u dëftùa njerì si na. Kështù tue ghrìsur njeriun tçë i glet, Aì po gjegjet si Perëndì t'i thonë: Aliluja!

IV

« Moj Virgjëreshë, Mëmë e Perëndis, Ti je mburonja e virgjërìs edhè e t'gjithë atireve tçë rriédhiën tek Ti: përsè Bëresi i kjielliës è i dheut, o zonjë e dëlirshime, të këtilë Tij t'shëmbëllèn, tue jétsur në gjì t'ënt è tue mbësuar gjithëve, sa të t'thëresiën:

U të falem, se ti je shtilla e virgjërìs;
ù të falem, se ti je dera e shëlbesës.

U të falem, se ti je è zë fill të përtrijturit të shpirtullòr;
ù të falem, se ti je è dhuròn mirësìn e Perëndìs.
U të falem, pse ti mënd'è u len pameta atà tçë klenë zënë në faj;
ù të falem, pse ti i dhe méndien atireve tç'e sbùartin.
U të falem, pse ti përfaròve kë shkatarròn méndiet;
ù të falem, se Tij t'u le Aì tçë mbìell pàstrën.
U të falem, se ti je dhomë nusërije të dëlirë;
ù të falem, pse ti sivàs të besmit me t'ën'Zonë.
U të falem, ò e Mìrëza tçë rrin è mbësòn virgjërìn;
ù të falem, se ti zëmbrat t'shéite i stolìs si nuse.

« U të falem, Nuse e pa-nusërte! »

« Ngë jarrën tçë-dò kënkë, o Zot, në një dot shtiéllë një bashk të gjitha, për sa të shuma janë lipisit t'ote. E vërteta, o Rregji i sheit, në Tij disà kënka t'i falshim na të nëmbrùame edhè sa isht rëra e dejtit, ngë mëndë kurr të sosiën gjë të vëjéfshim akjë, sa Ti na dhe të mira neve tçë po të thëresiëm: Aliluja!

« Virgjëreshën të sheite nà e vërréjëm, sè u duk si një dritë tçë llambarìs atireve tçë janë më t'errët: psè Ajò tue dhézurë Dritën shpirtullòre dëftòn dhromin për të njohur Perëndìn é, si shkëlkjèn, po ndrit méndien è me zë të lart nga të gjithë po vien ndertur kështù:

U të falem, se ti je një rrezë e Dìellit shpirtullòr;
ù të falem, se ti je një shëgjetë e dritës tçë ngë perëndon.
U të falem, se ti je shkreptìmë tçë shëndrìt zëmbrat;
ù të falem, se ti skur gjëmòn tue drerùarë armikjët.
U të falem, se ti mënd'e lehet Dritari me disà drita;
ù të falem, se ti mënd'e buròn Lumi me disà ùjëra.
U të falem, se ti i shëmbëllèn Pishkëtores;
ù të falem, se ti ndsìer sihjenìn e mëkatës.
U të falem, se ti je lumi tçë shplan vetëdijen;
ù të falem, se ti je kupa tçë derth gëzime.
U të falem, se ti je kjem i érës së këndëshme së Krishtit;
ù të falem, se ti je gjellë e gostìs së fshéhurë.

« U të falem, Nuse e pa-nusërte! »

« Aì tçë gjith njérzëvet i ndëjèn dëtirët, pòrsa deshi t'bëj hîr mbi fajët të motçëme, vetëvetìu Aì jerdhi tek atà tçë e lanë dhuràtën, è, të shkjerrit kartën e nëmës së parë, gjegjet nga të gjithë kështù të thëresiën: Aliluja!

Tue përméndur si t'u le, o Mëmë e Perëndìs, nà të gjithë duam të të ndériëm Tij si një faltòre me shpirt: përsè në gji t'ënt tue ndenjur i Zoti tçë me të dréitën mban gjith-kjish, Tij të shejtëròi è të lëvdòi, edhè gjithëve Aì i mbësòi, sa të të thërresiën:

U të falem, se ti je tabërnakull i Perëndis Fialë;
ù të falem, se ti je e sheite më e madhe sè shéitërésa dhéite;
U të falem, se ti je arkë me ar e stolisme nga Shpirti i Sheit;
ù të falem, se ti je i gjellës një tësuar tçë ngë mënd't'joset.
U të falem, se ti je kurorë e tçëmùashme e rregjëravet të besmë;
ù të falem, se ti je vëldia e ponìsme e priftëravet të lùtçimë.
U të falem, se ti je pirgu i pa-tundur i Klishës;
ù të falem, se ti je i rregjëris lédhi i papushtùtshëm.
U të falem, se pajë t'ënt ngrëhen shéngje mundësije;
ù të falem, se pajë t'ënt armikjët bien përmistë.
U të falem, se ti je kuidési i fitirës s'ime;
ù të falem, se ti je shëndétia e shpirtit t'im.

« U të falem, Nuse e pa-nusërte! »

« O Mëme gjithë e ndérshëme, Ti tçë pate Bir të lartën Fialë, Shéitin mbi gjithë sheitërat, nanì tue pritur mirë këtò të fala, na ruan të gjithë nga tçë-dò këkjì è na shpëtò, o Zonja Virgjërë, nga mundìmi i sprasm neve tçë Tij po thërresiëm: Aliluja!



RRUSARI I SHEN MERIS

Në embër të Jatit, të Birit, të Shpirtit Shejt. Ashtù kloft.

Paçe për mua lipisî, i Madh'in Zot! U ndienj pendim, o i Larti Perëndi, dhëmbem è helmonem me gjithë zëmbërë për gjithë mëkatët çë kam bër te gjella e jime. Helmonem, se kam sbjerrë Parraisin è më nget Pisa; po më shumë më dhëmp zëmbra, se, tue mëkatruar, kam ftesur Tij, i Madh'in' Zot, çë je gjithë e mira è çë kat dua mirë mbi gjithë shërbiset. U të taks me të vërtetë, me ndihmën t'ënde, të mos t'ftes më me mëkatën t'ime. Vdeksha më mirë! Po të dafsha mirë è të shërbefsha Tij, i Madh'in'Zot, i mirë e i ftet è klofsha me Tij për gjith-monë. Ashtù kloft.

O Zonja Virgjërë e Shën Mëri, dua sot të thom rrusarin shejt, e të truhem fort mos më lipset kurr lipisia e t'in'Zoti.

Misteret e gëzimevet

(tek e hënia e tek e intia)

1. - Nga Parraisi një i dërguar
pruri fjalën për të rruar
è kur uji kriet Mëria
te ajò zuri Perëndia.

Zonja e madhe kam harè
përsè ti e gëzuame je.

2. - Vate pran te Lisabeta
Zonja Virgjërë, è te jeta
ng'ish Shën-Jani, po u gëzua
e te gjiri u shejtërua.
3. - Mbi tsa kashtë e te një shpellë,
kur ish nata shum e thellë,
u le diali i krietarit
ndërmès kaut edhè gomarit.
4. - Si gjith't'ierazit faitort,
Virgjëresha ndë faltore
me të prunjur, mori e shkoi
è t'in'Zoti ja dhuroi.
5. - Kur i Larti Bir u sbuar,
vej Shën-Mbriza tue kërkuar;
mbi tri ditë te kjiteti
ndër të diturit e gjeti.

Misteret e helmevet

(tek e martia e tek e prëmptia)

1. - Brënda kopshtit parkales
I Pa-vdekti è ndien se vdes;
psherëtin tue dirsur gjak,
sa me atë gjith trolli u lak

O e helmuara e Shën Mërì,
Bashk me tij u jam ndë zi.

2. - Si një kjenkjëth e rrëmbien,
e pushtijtin, e shkarzien;
me shkupinj e vran è e sosën,
gjith e murrën è e lavosën.
3. - Mbret i falur për të kjeshur
me një tsopë t'kukje i veshur
miù vëlgn bashk një kurorë
e për shkop një kallm në dorë.
4. - E gjikuan si një kusar,
si një vrasës për të vrar;
kush e nëm è kush e rrahë,
kush e shan me krikjen n'grahë.
5. - Te ajò krikje e miera e jëmë,
si è kjëlluarë nga një gjemë,
të varruar, me mishtë shkjerrë,
sheh të birëthin të vierrë.

Misteret e vëldivet

(tek e mërkuria, tek e shtunia e tek e diellia)

1. - Si një trim ç'u zgjua nga gjumi,
Mbi tri dit'u ngjall i lumi.

Vate è Prindërat liroi,
è nga i ligu na shpëtoi.

Zonjë e lume e Shën Mëri,
bashk me tij u bënj haidhi.

2. - Mundësor, mbi dizet ditë,
Te Parraisi Krishti u ngjip,
i përitur me lëvdi,
me këndime e me haidhi.
3. - Ndë të lutur, Shën Mëria
rrij me Apostojit te shpia,
Shpirti i Shejt i taksur, erdhi,
è mbi tà të mirat derdhi.
4. - Kur arruri dita e thënë,
la e bekuamia jetën t'ënë;
te Parraisi in'Zot' e ftoi,
me gjith kurmin fluturoi.
5. - Mbretëresha ajò ndë kjiell
throni i saj shkëlkjen si diell
ësht hareja e Faremirit,
nuse, mëmë è bijë e t'Birit.

Na të falemi, o Perëndeshë

Na të falemi, o Perëndeshë, Mëmëza e jonë gjith-lipisî, gjella, ëmbëlsia, shpresa e jonë. Na Të falemi. Tij Të thëresiëm na të shkretit bijë t'Evës. Mbi Tij, o Mëme, psherëtojëm, tue rëkuar è tue klâr te kjo jetë e plotë me lotë. Andai Ti, e Shë-Mërizë, ndihma e jonë, prir mbi nê sît t'atë me lipisì e, si sos kjo jetë e shkretë, Ti dëftona pemën e gjirit t'ënt, Isuthin. Se Ti je e butë e t'ëmbël, gjith-lipisî, o Zonja Virgiërë è Shë-Mërì. Ashtù kloft.

Parkalesì t'in'Zoti

Na t'biem prëmist, o i madh'in'Zot, è të lutemi me gjithë zëmbërë; Të truajëm fort Klishën shejte, çë Ti stise në jetë, è Papën shejt, çë Ti vure në vent t'ënt.

Klisha e jote katolike po klofshit mundësore mbi gjithë të ligat è mbi gjithë errësirat edhè eresit. Mos të klofshin kurr ndajtur bijt t'at, o i Madh'in'Zot, po klofshit pakjëja e jote ndër gjithë kombet te jeta, çë Ti shpërbleve me gjakun t'ënt, akjë të shtrejt. U njomshin zëmbrat e të mëkatruamvet è gjetçin tek Ti lipisì. Të truajëm, o Zoti Krisht, gjinden t'ënë arbëreshe, ku do ndodhen edhè janë. Ti jipi dritën të t'njohëjën, hiret e bekimet sa të t'shërbejën, sa të t'denë mirë. Të truajëm gjirin t'ënë, mikjt, armikjt è gjith njerì, çë na truhen te parkalesia. Rrusari shejt çë jemi e thomi, vafshit edhè për shpirtërat çë janë te Purgatori.

Sa të kemi ndjesat shejte, parkalesiëm si do Klisha shejte, tue thënë:

Ati i jinë... Falem, Mëri, Vëldi past...

Litania e Shën Mëris

Kjirie eleison
Kriste eleison
Kjirie eleison
Gjegjëna, o Zoti Krisht,
Gjegjëna, o Krisht, gjegjëna.


Ati i kjielliës in'Zot
Bîr, shpërblês i dheut in'Zot — *Lipisî për ne*
Shpirt i Shejt in'Zot
Shejtia Mëmë e t'in'Zoti,
E Shën Mërì,
Shejtia Mëmë e t'inZoti,
Shejtia Virgjër'e Virgjëravet,
Mëma e Krishtit,
Mëma e të hjuinushmit hîr,
Mëmë e dëlirë,
Mëmë e ndershme,
Mëmë e pa-ngarë,
Mëmë e pa-ftesme,
Mëmë e dashurë,
Mëmë famasore,
Mëma e këshillit i mirë,
Mëma e Stisorit, — *Parkales për ne*
Mëma e Shëlbuesit,
Virgjërë e prënoreme,
Virgjërë e përfalurë,
Virgjërë e vëlduashme,
Virgjërë e pushtetëshme,
Virgjërë lipisiare,
Virgjërë e besme
Paskjira e ligjës,
Throni i urtësis,
Kroi i hares t'ënë,
Putçer shpirtulor,
Pëtçer i prënderm,
Putçer i ndritëm i të luturit,
Trundafile mistike,
Pirgjë e Davidit,

Pirgjë e éburtë,
Shpia e artë,
Arka e dhiatës,
Dera e kjielliës,
Illi i menatës,
Shëndetia e të sëmurëvet,
Pështrimi i të mëkatruamvet,
Gëzimi i të helmuamvet,
Ndihma e të krështerëvet,
Perëndesha e Engjëjvet,
Perëndesha e Patriarkravet, *Parkales për ne*
Perëndesha e Profetravet,
Perëndesha e Apostojvet,
Perëndesha e Martravet,
Perëndesha e Skomollerëvet,
Perëndesha e Virgjëravet,
Perëndesha e gjithë Shejtravet,
Perëndesha çë zure pâ e ngarë
nga faji i parë,
Perëndesha e Rrusarit shejt,
Perëndesha çë u ngjipe në kjiell
Shën Mbëriza Odhijitre,

Kjengji i t'in'Zoti, çë mëkatët e jetës ndsier, Ndëjena, o i madh'in'Zot.

Kjenkji i t'in'Zoti, çë mëkatët e jetës ndisier Gjegjëna, o i madh'in'Zot.

Kjenkji i t'in'Zoti, çë mëkatët e jetës ndsier Lipisî për ne.



UDHA E KRIKJES

Në embër t'Jatit...
Patçë lipisî... (v. pag. 20)

I

Rrij e Jëma e përlotuarë
Afër krikjit e helmuarë
Tek'i vdiste vierrë i Biri.
Bën të kem. o e Shën-Mëri,
Gjithë lavòmët në ktë gji,
Ç'in'Zot pati si njerì.
Ati i jinë... - Vëldî...
Na të falemi, o Zoti Krisht
E të bekojëm përçë me shejten
Krikje Ti shpërbleve jetën.

Metë e parë

Përpara sivet, o të krështerë, na kemi gjikatoren e Pilatit. Në mes t'armikjëvet, çë bërtasiën e lurijën se e duan vrar, çë e shajën e çë e nëmiën.

Zoti Krisht me duart të lidhura me tërkuzë rri tue mbajturë sît te dheu, i sbet, i përgjakëm, pa fukjì. Nga kriet shejt të shpuarë me glëmba, i kullòn gjaku për në ballit e për në fakjes; më çë do vent të kurmit ka misht të zi e të murrët për shkupinjët çë ka pasur. Disà të likjë e padisiën é e ngalesiën me të rremë e me të shpifura. Ngë sheh përkrahu as një mikj; ngë gjegjet një fialë të mirë t'e ngushëllonjë e t'i shkrifënjë zëmbrën. Pilati ngrëhet shtuara edhè e dëmnòn për të vrar. Aì e gjegjet me butësì e ngë shkjep gojën, ngë thot gjë, përçë e di se vdekëja e Tij ka t'jet gjella jonë. Aì merr mbi' të gjith fajet e gjithë mëkatët t'ona, e i kla për ne tue zënë vendin t'ënë sa t'na lanjë e të na shpërlanjë shpirtin.

Nga Pilati kle i gjëkuar
Zoti i jim si një fajtuar
E çë zëmbrë guri u kam
Në i pa-dhëmbëshim po jam?

Zoti Krisht të parkalès
Jipëm hir sa mos të t'ftes
Më të bie në faj ngë dua,
Lipisî kîj, Zot, për mua.

II

Asaj pamie të tmeruarë
E kish zëmbrën të dërptuarë;
Se një shpatë i u kreth te gjiri.

Bën të kem... (v. p. 1).

Metë e ditë

Përpara sìvet, o të krështerë, na kemi vendin te ku Krishtit i dhanë krikjen sa t'e kjellëj. Ai merr

mbi krahët me durìm të math, me gjith se ajò isht shumë e rëndë, e me gjith se Aì ngë j'a bën më të rrij shtuara. Krikja për atë isht si kujtesa e dashurìs të tij si flàmuri i lëvdìs çë ka të prinjë gjith gjinden e krështerë tek e shkreta udhë e gjellës. Aì e nglakòn me gzim atë barrë të tmeruarë dhunie, e si kur se thot: të kam përitur, të kam dishiruar, të kam dashurë.

Me atë krikje çë nglakove
Barrën t'ime lehtësove;
Nga kta krahë, o Zot, e nzore
E mbi Tij me pakje e more.

Zoti Krisht... (v. p. 3).

III

O sa hokji e sa duroi
Sa të kekje atjè pësoj
Për të vetëmin e' saj!

Bën të kem... (v. p. 1).

Metë e tretë

Përpara sìvet, o të krështerë, na kemi t'ën'Zonë çë bie te dheu përposh krikjes. Dhromi isht i kekj e i plot me gurë; zë fill përpieta e malit, e Krishti isht shum i lodhët e i sost, më shumë për barrën e mëkatëvet t'ona se për atë të drurit. I dridhen glunjët e Aì bie, me fakje të përmistë te bota, e jep ballët shejt mbi gurët, si i plagosur nga mbria e ligjës të pa-sosme; Aì duket nië krimp i dheut çë na shkeliëm; e ashtù me të vërtetë Aì i shkelur e i

ndridhur nga atà çë ka nd'anëzë e çë pran e shtrëngojën të ngrëhet me shkelme, me shkupinj e me të shara.

Zoti jim, çë shoh të rar
Të helmuarë edhè të shar
Më vjen kekj se me mëkatë
U po shtonj pësimet t'atë.

Zoti Krisht... (v. p. 3).

IV

Tuke e par ashtù të vuaj
Nga gjith kurmi gjak të çuar;
Psherëtij e bënte vaj.

Bën të kem... (v. p. 1).

Metë e katërtë

Përpara sivet, o të krështerë, na kemi t'ën'Zonë çë përpikjet me të dashurën Mëmë. Ajò e mjera sheh te Birthin, dialin çë kish rritur me akjë kujdès, çë kish ngrohur me ahtin e gjirit t'saj; për të çilin kish pasur akjë drê kur Erodhi i parë e kërkoj; për të çilin kish klar akjë kur e sbori për tri ditë në Jerusalim, e sheh ndër mes t'armikjëvet ç'e kjelliën sa t'e vrasiën; e sheh gjith gjak çë te kriet njera te këmbët; të dërsijtur të plot me bajt, të përkjeshur e të nëmurë nga gjith gjindia. E Ajò ng'isht e zonja t'i kjaset, t'e përkjafonjë, t'e puthnjë, t'i fshinjë edhè një pikë diersish. Ahierna ndien se një shpatë i shpon zëmbrën te nj'anë e nj'etrë. E vërren pa folë, kjëndròn më vent, si një tsopë gurë, e ngë i derdhet më një lot nga sit. I pa-rrëfieshim isht helmi i'saj!

Bir e Mëmë në hjidhi
Për të nëmurin njerì
Tue par juve zëmbra jime
Zë e vajtòn e shtie rëkìme.

Zoti Krisht... (v. p. 3).

V

Kush mënt t'rrij atje pa klar,
Në mundimin e kish par
Te ku ndodhej Shën-Mëria?

Bën të kem... (v. p. 1).

Metë e pestë

Përpara sivet, o të krështerë, na kemi t'ën'Zonë, çë isht i ndihur të kjellënjë krikjen nga Simòn Kirinéu. Mos të ju duket se Judhenjëvet i jerdhi kekj kur pan se Krishti ish shuaj për në dhromit! Jò, se atà të likj muarën atë njerì ç'ish e shkoj atei é e shtrënguan të nglakòj krikjen, përçë ndëlguan se Isui ngë mëndë t'arrëj i gjallë te maja e malit, e se atà ngë mëndë të kishën gëzimin e tmeruar t'e shihiën vjerrë me goxhda sa të vdisëj mbi drurin e shkret. Po in'Zot deshi të kish ndihmën e një burri sa të na mësòj neve se si për ne Ai mori pësime e mortë, ashtù na, tue rruar si nget e tue bërë vullimin e të Lartit, kur na nget me glishtin e Tij, mbiedhiëm pemën e durimevet të koposevet çë Ai shkoi për dashurìn t'ënë, e ashtù e gëzojëm, perçë për pak mot çë klam te dheu, do të kemi një lumëri të pasosme te Parraisi çë Ai na sbilli.

Nga një burrë me dhëmbìm
Pate ndihmë, o Zoti i jim,
E kur u ktë fat do t'kem

Ndihmëtari jit të jem?
Zoti Krisht... (v. p.).

VI

Kush pa lot'mënd t'kish kjëndruar
Në i kish par akjë t'trishtuarë.
Mëmë e Bir ndër të këkija?
Bën të kem... v. p. 1).

Metë e gjashtëtë

Përpara sivet, o të krështerë, na kemi atë grua me zëmbër të mirë, çë ndër mes të ushtarvet e të Judhenjëvet të tërbuar, shkon pa u trëmburë, do e mos do, me gjith se atà kërkojën t'e ndalojën e t'e përzën me fialë të liga e me purtekata. Ajò shkon ndër atë shumizë e ndër atë tuf burrash t'egërsuar, e i kjaset t'in'Zoti me lotë te sit, e me një napë i fshin fakjen shejte të nxhurdhikjurë me gjak, me djers, e me botë. E i Madhi in'Zot deshi të paguaj mirësin e saj e i la te ajò napë një shenk të pâ-çëmuar e të pa-harroshëm dashurije, përçë i la atje fitirën e tij të shejtëruamen.

Oh çë mall, o çë dalshirë
Ti le shejtëzën fitirë,
Fakjen t'ënde mos t'harrojëm,
Sa na deshe të kujtojëm.
Zoti Krisht... (v. p. 3).

VII

Për mëkatët e mëdhà
Të gjith gjindes, Ajò pa
Të mbërthier Jesuin ndë krikj.
Bën të kem... (v. p. 1).

Metë e shtatëtë

Përpara sivet, o të krështerë, na kemi t'ën'Zonë, çë ra te dheu pameta. Dielli djek e vdiset vàpiet. Zoti Krisht i lidhur e i penguar si kusar, me buzët të tsaposme, me gojën shkrump, si i përvëluam te fakjia, me kriet ç'i zien, tue ahtarisur sa duket se zëmbra isht e i pëlcet. Ndien se glunjët i njomen, se sit i mirren, se mendia i lot; vu këmbën te një gropë e bie të dijtën herë. I shtihen sipër Judhenjët e sogarët; kush e rrëmben për kripi, kush e zë për një krahu, kush e helkj me tërkuzën çë i kishën lidhur te mesi, kush e rrah me thuprën, e kështù e ngrëjën tue luritur si të llavur, tue trojtur, tue nëmur, tue shajtur.

Të përmisem përsëri
U të shoh mbi dheun e zi,
Shoh se të ngrëjën me shkupinj
E tue klar u psherëtinj.
Zoti Krisht... (v. p. 3).

VIII

Pa të dashurin të Bir
Kjenkjin shejt e të dëlir
T'idhëruar gjer çë vdikj.
Bën të kem... (v. p. 1).

Metë e tetëtë

Përpara sivet, o të krështerë, na kemi vendin te ku in'Zot, tue harruar gjith dhullimet e'tij, u pruar e i tha gravet e mira çë i vejën prapa tue dënesur e tue vajtuar: mos klani për mua po dërdhëni lote mbi ju

e mbi bijt t'aj. Me këtò fialë Zoti Krisht na mësòn se ng'isht gjë më e kekje se mëkatia, se mëkatia isht ajò çë Atë e helmòn më shumë; se nga ajò po i vijën njeriut gjith të ligat, e se na kemi të klam e të lipiëm ndjesë me gjith zëmbrë kur e ftesiëm Perëndin, në ngë duam të njohiëm e të ndiejëm mbrin e'Tij te kjo jetë edhè më shumë te ajò t'jatra.

Atò fialë çë Ti thua
Pengje malli jan'për mua
Shtrejt i mbanj e të bënj bê
Se do t'rronjë me shejten drê.
Zoti Krisht... (v. p. 3).

IX

Eja, o Mëme, e Mallit krua
Njomën zëmbrën edhè mua
Bënmë Ti të kla me Tij.

Bën të kem, o Shën-Mëri...

Metë e nëndëtë

Përpara sivet, o të krështerë, na kemi t'ën'Zonë, çë për të tretën herë bie te dheu. Më çë vete, dhromi bënet më i ngusht e më i lik, me gurë, me glëmba, me gropa. Lusma e ushtëtarëvet é e Judhenjëvet isht si e dejme. Më çë afronet te vendi ku ka të bënet vrásia e tmeruar, shumiza më shumë dhizet, tërbonet e ndien étë gjaku. I lurijën t'anangaset, é e shtijën të ve përpara me fialë të poshtra, me shkupinj, e me grushtë te krahët. Ai kërkòn të jecënj, po frima i lipset isht gurgurth te gjith kurmi me gjak e me djers; ngë j'a bën më e gorromiset te dheu nën

krikjes. Ahierna si të marrurë e si të dalë trush, armikjt i shtihen n'grahë me rrëmbim më të math; e zën, dhe e dsarrisiën me pahir njera te maja e malit. Krishti ra te dheu për të tretën herë, ndiejti te zëmbra e'Tij një dhëmbie të fortë shumë, më e forta e më e madhia e gjithve, përçë Ai kujtoj ahierna gjith atà njerëzë çë ngë kish't'fitojën gjë nga mundimet e nga vdekja e Tij.

Rar të shoh të tretën herë
Zoti jim; me zëmbër të prerë.
Nga njerì si kjen të sulet,
Në gjì, shpirti mua më shkulet.
Zoti Krisht... (v. p. 3).

X

Bën të dhizem gjith u sot,
Tuke dashur Krishtin Zot;
Të gjenj hîr perpara atij.
Bën të kem... (v. p. 1).

Metë e dhietëtë

Përpara sivet, o të krështerë, na kemi majën e kallvarit, te ku ligja e Perëndis pret theroren e dheut. Ushtëtarët pa durim e pa lipisî, si ulkj të urët, shtihen mbi kenkjin e but, i shkuliën robbikun çë ju kish ngjitur te misht me gjakun e piksur; e xheshiën me likurë, i lagiën gojën me uthull e me t'amëth, é e lën ashtù të tërpëruar e të dhunuar përpara gjithve ç'e vërrejën tue kjeshur. Ai rri me sit te dheu, ngë thot gjë, ngë tundet tue pritur të jet vunë n'grikj.

Krishti jim, çë rri ashtù xheshur,
Nga gjith gjindia i përkjeshur,
U t'përujem me të klara,
e të vu zëmbrën përpara.
Zoti Krisht... (v. p. 3).

XI

Bën të kem, o Mëma e jime,
Te kjo zëmbër atà plagime
Ç'edhè pati Biri i jit.
Bën të kem... (v. p. 1).

Metë e njëmbëdhietëtë

Përpara sìvet, o të krështerë, na kemi t'ën'Zonë, kur jan'é e ngjijën te krikjia tue dëndur pa mëshirë goxhda te duart e te këmbët e tij. I shtruar mbi krikjen, Ai vërrèn kjielliën, tue pasur tùtulin mbi glëmbat. Dhullimet çë rien te kjo herë ngë mëndë të rrëfihen! Misht i shkjiret, éshtërat i dajën nga vendi, dejt i ndenen e i dridhen, rremat i këputen, e gjaku rrieth e i buròn nga gjith kurmi shejt, çë dridhet e shtrëmbonet pa luar nga vendi. Të shpuara janë atò duar çë dhanë akjë bekime e çë bën akjë të mira; të shpuara janë atò këmbë çë rrahën akjë tue kërkuar fajtorët!

Goxhda t'mprehta të t'in'Zoti
Shponi mua çë faji ndoti;
Mua më nget të jem i angosur,
Mua më nget të kla pa-sosur!
Zoti Krisht... (v. p. 3).

XII

T'atij Biri të lavosur,

Çë për mua desh t'ish i angosur,
Brengat ndaj me mua këtë ditë.
Bën të kem... (v. p. 1).

Metë e dimbëdhietëtë

Përpara sìvet, o të krështerë, na kemi t'ën'Zonë vjerrë te krikja ndër mes të dî kusarëvet. Ish një tsop gjak çë te kriet njera te këmbët; mbi fakjen shejte ndenet verdhësira e morties; kriet i viret përpara; zën é i mbillen sìtë çë patën akjë dritë dashurie për njerëzit; i ftohen atò buzë të bekuara, nga duallën akjë ndiesa, kjaset hera e sprasme, e një thirmë e lartë jik nga gjiri i lavosur: O Tate, te duart t'ote u truanj shpirtin t'im. Krishti vdikj e dielli u vrër; dheu u shkunt, gurët u thiejtin e gjith jeta u vu ndë lip.

Helm i math! Krishti vdikj
Ndër kusarë i vjerrë ngrikj!
I pa-ftesmi, i drejti u-shua!
Sit e mi, pa bënij krua!
Zoti Krisht... (v. p. 3).

XIII

Bënmë t'kla me tij t'ën'Zonë
Kekj të m'duket për gjith-monë
Çë do t'jem i gjall ndë botë.
Bën të kem... (v. p. 1).

Metë e trembëdhietëtë

Përpara sìvet, o të krështerë, na kemi Zonjën e Shën-Mërìn, t'ujurë afër kutserit të drurit, mbi një gur, tue pasur mbi glunjët të dashurin kurm, ashtù

të shkjerrë e të përgjakëm të Birit t'saj, çë tsa vetë të mirë kishën pasur thelimë të shkuliën e të sbrisiën nga krikja. Nga njerì nesh mëndë t'e ndëlgonjë sa i math isht helmi i Shën-Mëris, çë sheh të vdekur dialin e saj të vetëmin. Ajò e puth, e shtrëngòn në gjî é e lak me lotë, tue thënë: O drita e sìvet t'ime, si m'u shuajte! O Bîr, o zëmbra jime, te ku vate bukuria jote! O Bîr, o lule e gjellës t'ime, si të shoh kështù të veshkurë, sa edhè ngë m'njihe më!

Mëmë e mjerë, u të lavòsa,
Se t'ët Bîr u vrava e sosa.
Pr'atë Bîr çë ke me duar,
Ndjesë t'lip tue psherëtuar.

Zoti Krisht... (v. p. 3).

XIV

Afër krikjit dua të rinj
Çë Ti reve, e dua t'përzienj
Bashk me Tij e lip e lot.

Bën të kem... (v. p. 1).

Metë e katërmbëdhietëtë

Përpara sìvet, o të krështerë, na kemi varrin e ri te ku dsënësit e tsa gra të mira kan të vun kurmin e t'in'Zoti. Tue klarë e liejën me vajëra të mira, e me prëtime të pa-çëmuara, edhè e pështiellën te një pëlhurë e bardhë, pran e marriën me kujdes edhè e kumbisiën brënda martumit; e vërrejën të sprasmen herë me sit ndër lot, e bien më glunjë tue dënesur e tue u shëmburë. Varrëzojëm, o të krështerë, tek ai varr shejt gjith dishirimet e kurmit; shtiem atjè brënda të gjitha dashurit e

dheut, çë na llargojën nga dashuria e t'in'Zoti; vum një gur mbi ndienjat e përdhèshme, si mikjt e Zotit Krisht j'a vun mbi kurmin e'tij, e me shpres'e me besë të gjalla rrim e presiëm, tue klar mëkatët t'ona, herën e vdekjes çë ka t'na përbashkonjë me Perëndin te vendi i dritës, te vendi i lumëris, te vendi i harès të pa-sosme.

Eja, o Zot, e u varrëzò
Te kjo zëmbër é e shejtërò;
Njome e çaje, t'ket shëndetë
Me një dhëmbie të vërtetë.

Zoti Krisht... (v. p. 3).

Viret sot

Viret sot mbi një dru Ai çë ndë ujëra dheun vori (3 *herë*).


Kurorë glëmbash i vun rreth kreit mbretit t'Engjëjvet.

Një tsopë t'kukje për të kjeshur i vun mbi krahët Atìj çë vesh kjiellin me miegulla.

Shplaka duroi të kish. Ai çë liroi Adhamin në Jordhan.

Me goxhda kle vierrë Dhëndëri i Klishës. Me shtizën kle i lavosur, i Biri i Virgjëreshës.

Na i falemi pesimevet t'atë, o Krisht (3 *herë*). Dëftona të ngjallurit t'atë të lëvdoshmit.



Vajtimet e Shën-Mëris

Zoti Krisht, o gjellë, edhè Ti ndë varrë!

E gjith Engjëjvet ushtrit po famaseshin tue lëvduar sa u përuje, i Larti Zot.

Po si vdes, Ti gjella? Si ndë varrë Ti po rri? Ngë je Ti çë përfaròn edhè vdekjen, çë të vdekurvet pamëta gjellë i jep?

Jinit të gjitha-varrin t'ënt me kënka-po ndëriën, o Zoti jim.

Me kujdès nga druri-Josefi të sdripi-edhè të vu te varri.

Grat e mira jerdhën-tue prur Tij vaj-erësh-me hîr, o Krisht, te zëmbra.

Ejani, t'i thomi-kënka vaji t'Zotit, na gjith bîj t'Krietarit.

Tue par Tij e Shën-Mëria t'rar edhè pa frimë, t'ëmbël, zë ajò, vajtimin:

O i drita e sivet tim,-O i Bîr o zëmbra jime-Edhè Ti kshtù te varri?

O paraverë e t'ëmbël-O i Bîr i jim i t'ëmbël-ku t'vate bukuria?

Dot lëvdonj, o i Biri-Të Lartën Lipisî-Sa gjith kto durove.

Pâ greu shpejt, pâ ngjallu, o i Bîr, në ndsir helmin mua Mëmes çë të leva.

Dhurò neve ndiesën-çë me të dashur të nderiëm Pesimet t'at me dhimë.

Parkalesì

O Perëndì çë sa të shpërbleje jetën deshe të leheshe, t'ishe i prer, i mohuar nga Judhenjët, i përdhënë me një të puthur, i lidhur si kusar, i helkjur si një Kjenkj i pa-faishim, e përpara Anës, Kaiafës, Pilatit edhè Erodhit deshe t'ishe i ftesur, i shar, i shkërzier, i kalzuar nga dëshmor të rremë. O Perëndì çë deshe të kishe shkupinj e shplaka, t'ishe i ndrishur e i helmuar, i pushtijtur, i rrahur e i kurorëzuar me glëmba, çë deshe të kishe sît të pështruar me një napë; çë deshe t'ishe i xheshur, i ngjitur mbi një krikje në mes të kusarëvet, çë deshe të pije t'ambëth e uthull, e t'ishe i lavosur me një shtizë; Ti, o Zoti Krisht i jim, per gjithë mundimet t'atë, çë më hapën mua udhën e gjelles, për krikjen shejte, për pësimet e për vdekjen t'ënde, shpëtomë nga Pisa e kîj mirësin të më kjellësh atjè te ku kjelle kusarin e mirë të krikjëzuar bask me Tij, e te ku Ti me t'ët At e me Shpirtn Shejt rron e mbretëròn për gjith jetë të jetëvet. Ashtù kloft.

O Zoti Krisht çë te kopshti dërsijte gjak.
Pop. Kij lipisî për nê.
O Zoti Krisht çë me një të puthur kleve dhënë te duart e të pabesmëvet.
O Zoti Krisht çë kleve shar e përkjeshur nga gjindia si më i madhi të mëkatruamvet.
O Zoti Krisht çë i lidhur te një milezë kleve rrahur pa mëshir me thupra e me purteka.
O Zoti Krisht çë kleve i kurorëzuar me glëmba.
O Zoti Krisht çë kleve kjellur t'ishe vrar si një dele e butë.
O Zoti Krisht çë nga e gjashta njera tek e nendëta orë kleve i munduar mbi krikjen.
O Zoti Krisht çë kleve i lavosur përpara sivet e Shejtes Mëmës t'ënde.
O Zoti Krisht çë me pesë lavoma kleve i dërpëtuar te duart, te këmbët edhè te gjiri i shejt.
Zoti Krisht çë kleve nzierrë nga krikja e vunë te një var i ri.
Me të vërtetë mbi të Ai mori të gjithë koposet t'ona.

E gjithë helmet t'ona Ai deshi të duroj..



KATEKIZEM I VOGEL

U i mëkatruam skomollisem

U i mëkatruam skomillisem me t'lartin Perëndî, me Shën Mërin Virgjërë, me gjithë Shejtrat, me tij, zot, çë je në vent të t'in'Zoti; pse kam mëkatruar shumë me tru, me gojë, me të bëmë. U i ftes, u shumë i ftes.

Ati i jin

Ati i jin çë je në kjiell, shejtëruar kloft embri jit, arthët rregjëria e jote, u bëft vullimi i jit, si ndë kjiell ashtù në dhe. Bukën t'ënë të përdiçëmen ëna neve sot, ndëjena dëtirët t'ona, ashtù si edhè na ja ndëjejëm të dëtëruamvet t'anë, e mos na le të biem ndë ngarie, po lirona nga i ligu. Ashtù kloft.

Falem Mëri

Falem Mërì, e hi-plota, in'Zot ë me Tij. Bekuarë Ti je mbi gjith grat, è bekuarë pèma è gjirit t'ënt Isuthi. E Shën Mërì, Mëma e t'in'Zoti, parkales për ne, të mëkatruamit, nanì e te hera e vdekjes t'ënë. Ashtù kloft.

Vëldì past

Vëldì past Ati, Biri, Shpirti Shejt, nanì edhè për gjith-monë mbë jetë të jetëvet. Ashtù kloft.

U kam besë

U kam besë te Perëndia, Ati i gjithmëndëmi, çë bëri kjielliën e dheun. Edhè te Iisù Krishti, i Biri i'tij i vetëmi, Zot i jinë. I çili zuri pajt Shpirtit Shejt e leu nga Virgjëra e Shën Mëri. Duroi nën Pontsëj-Pilatit, kle vënë ngrikj, vdikj e kle varzuar U sdrip te Pisa; të tretën ditë u ngjall së vdekurish. U ngjip te kjiellia e rri te ana e dreitë e t'Jatit, të gjith-mëndëmit Perëndi. Andai kat vinjë pameta të bënjë ligjë mbi të gjallët e mbi të vdekurit. U kam besë te Shpirti Shejt, te Klisha Shejte, kathólike te shokyëria e shejtravet, te ndëjesa e mëkatëvet, te të ngjallurit e kurmit, te jeta e pasosme. Ashtù kloft.

Të parët Mistere të Besës

1. Njënia è Trinia e Perëndis. 2. Të mishëruarit è vdekja e Isù Krishtit.

Urdhurimet e t'in'Zoti

1. U jam Zoti, Perëndia i jit:
Mos t'kesh tierë Perëndira, veç meje. 2. Mos të bësh embrin e Perëndis më kot. 3. Kujtou të shejtrosh të Krëmptiet. 4. Të ndersh t'ët at e t'ët'ëmë. 5. Mos t'vraç. 6. Mos të ndohesh. 7. Mos t'viedhësh. 8. Mos t'bësh dëshmì të rreme. 9. Mos të dishiròsh gruan e nj'etëri. 10. Mos të dishiròsh petkun e nj'etëri.

Urdhurimet e Klishës

1. Të shohiëm Meshën gjithë të dielliat e gjithë të Krëmptiet të urdhuruame. 2. Të argjërojëm te Kreshmët e tè të tierat ditë të urdhuruame nga Klisha. Mos të hamë mish tek e mërkuria, tek e prëmptia e të tierat ditë të lidhura. 3. Të skomollisemi edhè një herë te viti e të kungonemi te Pashkët te Klisha e jonë. 4. Të paguajëm Klishës të dhietëtën piesë, çëdò i nget, ashtù si isht zakona. 5. Mos të bëjëm dasma te kjëronjët të lidhurë.

Sakramentet

1. Pagëzimi. 2. Krisma. 3. Kungimi. 4. Skomollia. 5. Ofkjeja. 6. Priftëria. 7. Kurora.

Veprat e lipisis për kurmin

1. T'i japëjëm të han atire çë janë t'urmë. 2. t'japëjëm të pin atire çë kanë ètë. 3. t'veshëjëm t'dçeshurit. 4. t'japëjëm vent shtektarëvet. 5. t'vemi è shohiëm të sëmurit. 6. t'vemi è shohiëm atà çë janë në fulakji. 7. t'varrëzojëm të vdekurit.

Veprat e lipisis për shpirtin

1. t'japëjëm këshill të ndërdishmëvet. 2. të mbësojëm të padijturit. 3. t'kjërtojëm të mëkatruamit. 4. të ngushëllojëm të helmuarit. 5. të ndëjejëm ftesat. 6. të jemi të duruashmë me kë do t'na varesnjë. 7. t'i lutemi Perëndis për të gjallit e për të vdekurit.

INDICE

Introduzione	pag.	3
Dhoxolojia	»	5
Mesha	»	7
Parkalesia më parë se kungimi	»	20
Parkalesia pas kungimit	»	24
Polieleos	»	27
Trisaghion	»	29
Lazëri	»	33
Këngëza Isuthit në Sakrament	»	35
Këngëza Zotit Krisht	»	40
Këngëza Shën Mëris	»	51
Hymni akathist	»	81
Rrusari i Shën Mëris	»	94
Udha e Krikjes	»	101
Katekizëm i vogël	»	117